




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe ne pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 29.02.2024, (ditë e enjte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit.

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
4. Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, me anëtares znj. Ervina Vojvoda, si dhe dhënia e betimit, me Nr.01.020/01-0010609/24, të datës 21.02.2024, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu);
5. Propozim-vendim për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Politik dhe Financa (KPF) znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, me Nr.01.020/01-0010606/24, të datës 21.02.2024, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit znj. Adelina Spahiu);
6. Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, znj. Blerta Dobra-Geci);
7. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT
znj. Adelina Spahiu

Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. 01-060/01-00/0587/24
Data 21.02.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 28.12.2023, ora 10:00.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, (Raporton Kryesuesja e Kuvendit **znj. Adelina Spahiu**);
5. Plani i Punës i Ekzekutivit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, me Nr.02-112/01-0063732/23 të datës 21.12.2023, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
6. Propozim-vendim për Nismën e Kryetarit të Komunës së Skenderajt për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar (binjakëzimit), me Komunën e Tuzit të Malit të Zi, me Nr.02-053/07-0061502/23, të datës 07.12.2023, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
7. Raporti i punës së Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023, me Nr.02-112/01-0063718/23, të datës 21.12.2023, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
8. Informatë lidhur me vendimin e kuvendit me Nr.01-112/01-0050960/23, të datës 29.09.2023, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
9. Propozim-vendim për miratimin e vendimit për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2024, me Nr.01-463/01-0062208/23, të datës 13.12.2023, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
10. Propozim-vendim për miratimin e vendimit paraprak të vendimit për ndryshimin e kufirit të Zonës Kadastrale Llaushë-Skenderaj, duke bërë bashkimin e ngastrave nga ZK-Llaushë, në ZK-Skenderaj, me Nr.02-350/04-0062272/23, të datës 13.12.2023, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
11. Propozim-vendim për miratimin e Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), për Komunën e Skenderajt, Nr.09-112/01-0061908/23, të datës 11.12.2023, (Raporton Drejtori për DSHP-së, **z. Alban Shala**);
12. Raporti i monitorimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023, për vitin 2023, me Nr.12-052/01-0062576/23, të datës 14.12.2023, (Raporton Drejtoresha e DZHENIT-së, **znj. Besarta Meha-Ademi**);

Pikat shitesë për këtë rend dite:

13. Propozim-Vendim Për miratimin e Raportit Përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga era dhe fatkeqësitë tjera në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023 me Nr. 02-020/01-0065420/23, i datës 28.12.2023 (Raporton Drejtori për DSHP-së, **z. Alban Shala**);
14. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 29 anëtar, mungon me arsye Ragip Durmishi, ndërsa pa arsye Arjeta Rama.

Para miratimit të rendit të ditës e kemi një pikë shtesë;

-Propozim-Vendim Për miratimin e Raportit Përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dërmeve të shkaktuara kryesisht nga era dhe fatkeqësitë tjera në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023 me Nr. 02-020/01-0065420/23, i datës 28.12.2023.

-Shkojmë në votim për futjen në rend dite, te kësaj pike:

Konstatojmë me (17) vota për, (2) kundër dhe (8) abstenim, futet si pikë shtesë në rend dite Propozim-Vendim Për miratimin e Raportit Përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dërmeve të shkaktuara kryesisht nga era dhe fatkeqësitë tjera në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023.

Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kalojë:

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, në rend dite është një informatë që nuk ka material, është prej rasteve të rralla kryesuese pse ka ndodh kështu, se ti je personi që duhesh me u përgjigj, pse është kjo informatë pa material në rend dite?

Kryesuesja; Faleminderit, Hysni sa të vjen radha e informatës kryetari i jep sqarimet për këtë informatë, dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet Rendi i Ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës:

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (29) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Procesverbali nga mbledhjes e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës:

-Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, (Raporton Kryesuesja); **Kryesuesja;** Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore. Këtë plan e kam hartua me bashkëpunim me sekretarin e kuvendit, janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente sipas nevojës, siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, E nderuar Kryesuese me shume kujdes kam lexuar planin e punës se Kuvendi për vitin 2024 ku janë te përcaktuar objektivat dhe aktivitete për seancat e rregullta te kuvendit. Duke ditur se gate këtij viti kemi mos përmbushje te planit te punës se kuvendit për vitin 2023 nga ana juaj si kryesuese, nuk e di a ka kuptim ky plan i ri juaj për vitin 2024 kur nuk e kemi një përmbledhje te objektiveve dhe aktiviteteve të arritura që janë të parapara për vitin 2023. Ky plan i hartuar për vitin 2024 mbi 50% të aktiviteteve të parapara janë të planit të viti 2023 ku qëndron dallimi i këtij plani kryesuese. Kryesuese e nderuar deri me sot keni dështuar të përmbushni planin e punës për vitin 2023, keni bere mire që mbi 50% objektiva dhe aktivitetet e parapara për vinin 2023 i keni barte vet për vitin 2024 që tregon së nuk keni kryer detyra e juaj si kryesuese e këtij kuvendi, po ti potencoj disa pika që janë me rendësi për punën e juaj si kryesuese; -Mungesa e raportit vjetor të punës tuaj rreth përmbushjes së planit të punës për vitin 2023.-Mos përmbushja e obligimeve ligjore të kuvendit, duke lënë komitetin për politik dhe financa mbi gjate muaj pa kompletuar anëtarët e këtij komiteti. -Raportin vjetor të punës mbi

gjendjen e ndërmarrjes komunale "Eko Natyra Sh.A, së po ashtu nuk keni bërë as auditimin e kësaj ndërmarrje komunale, që e keni për obligim ligjor për monitorimin e punës dhe funksionalizimin e kësaj ndërmarrje komunale. -Raportin vjetor për ndërmarrjen regjionale KRM Uniteti Sh.A rrejtësia ne Skenderaj, edhe pse në planin e punës për vitin 2023 ne muajin Dhjetor 2023 e keni te planifikuar qe do te thotë se ne këtë seance te kuvendi e keni pas për obligim me sjell ne kuvend por qe ju nuk e keni sjell raportin pasi qe kjo është puna juaj kryesuese. Ne planin e punës për muajin dhjetor te vitit 2024 ju keni planifikuar raportin e punës për KRM Unitetin dhe Eko Natyra Sh.A, kryesuese ju jeni ne krye t këtij kuvendi mbi dy vite dhe ende nuk jeni ne gjendjes t silleni një raport për këto dy ndërmarrje, ku qëndron problemi kryesuese. Kryesuese edhe një here kërkoj nga ana juaj raportin vjetor për gjendjen ne Ndërmarrjen Publike Lokale Eko Natyra Sh.A, dhe planin për investime e parapara për të ardhmen e kësaj ndërmarrje, ku dihet se kuvendi Komunal është 100% aksionare edhe ka për obligim fuqizimin dhe funksionalizimin e kësaj ndërmarrje.

Hysni Mehani-LVV: Kush e ka bërë këtë plan pune të kuvendit për vitin 2024, cila instancë, sepse është e pa qartë, Komiteti për politik e financa apo e bane ti, sepse ti ju ke referua ligjeve, po çka thonë ligjet se qysh behet plani i pune të kuvendit për vitin 2024, për besë po të kursejmë, po je kryesuese dhe është përgjegjësi e madhe që je aty, dhe nuk mundesh me lejua kuvendin me ra në këtë deregje.

Sala Jashari-E PAVARUR: Fjala përshëndetje, edhe unë nga analizat që e kam bë për këtë plan pune të kuvendit për vitin 2024, të nisur nga objektivat e parapara ju kisha sugjerua që të bëhet riformulimi i tyre për arsye së janë të paqarta si objektiva. Një prej shembujve së në përgjithësi janë të njëjta, thotë: Informatë për mbrojtje nga zjarri, që duhet të jetë i përcaktuar dhe i qartë, dhe këtë objektiv për mua është i një rëndësie e jashtëzakonshme që të vendoset në planin e punës së drejtorisë së arsimit, informimin posaçërisht të nxënësve në shkolla për mbrojtje nga zjarri, tërmetet, që d.m.th. objektivat janë të paqarta për vitin 2024, dhe nëse ka mundësi që të bëhet edhe një herë riformulimi.

Afrim Kabashi-NSD: Fjala përshëndetëse, plani i punës së kuvendit Skenderajt për vitin 2024, E nderuara Kryesues e kam lexuar planin e punës së kuvendit për vitin 2024 ku janë përcaktuar objektivat për seanca të rregullta të kuvendit, andaj pajtohem me qëndrimet e shprehura te parafolësit kolegu Naser Bajraktari, andaj kam edhe pyetje konkrete a kem ndonjë raport apo jo nga komisioni i aksioneve KRU "Uniteti" Dhe pyetja tjetër është në këtë plan një vjeçar të kuvendit a keni shti ndonjë propozim nga ana e asamblistëve të kuvendit të propozuar gjate seancave?

Kryesuesja: Sa i përket planit të punës së kuvendit për vitin 2024, të gjitha raportet do të sjellën në janar qysh është praktikuar edhe vitin e kaluar, dhe ka me kërkuar edhe nga ekzekutivi që me ju përmbajt planit të punës së kuvendit, dhe ky plan pune është përpiluar në bazë të ligjeve rregulloreve, dhe është përkujdesur me se shumti sekretaria e kuvendit, Dikush tjetër, nëse nuk ka, Konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (1) abstenim miratohet Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës:

-Plani i Punës i Ekzekutivit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, me Nr.02-112/01-0063732/23 të datës 21.12.2023, (Raporton);

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura; Fjala përshëndetëse, Plani i Punës i Ekzekutivit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, në këtë planë janë përcaktuar objektivat në fushat e caktuara si zhvillimi ekonomik, ofrimi i shërbimeve, zhvillimi i arsimit, shëndetësia kultura, rinia dhe sporti, ky planë është për së cilën drejtori, dhe pres kontributin e së cilit për këtë planë pune të ekzekutivit. **Kryesuesja;** Faleminderit kryetar, e hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Plani i Punës i Ekzekutivit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, e përcakton të ardhmen për një vite të qysh ka mu qeverisë Skenderaj, e na nuk mundem me marr parasysh së çka ka ndodhur edhe në vitin paraprak. Pra ky planë i punës dot duhej me pas një kapitull të veçantë bolld viktimizimi, pra na e kemi pa kjo qeverisje është e aftë me ja lanë fajin qeverisjes qendrore për ujin dhe për rrugën, me na tregua qysh ka faj qeveria qendrore edhe për tregun plot lloç, edhe për stacionin e autobusëve që është bë objekt hajgare, edhe për qytetin që e marrin vërshimet kur bien 5 min. shi. Pra është shume e rëndësishme me na tregua qysh kanë me ja lanë fajin qeveris qendrore edhe për krejt dështimet tjera, së viktimizimi dot duhej me qenë kapitulli kryesor i kësaj qeverie. Tjetra është e padrejtë në këtë plan pune mos me qenë Albin Kurti, Albin Kurti duhet kapitull edhe pak me i gjatë qysh keni me dhënë epitete tjera, qysh keni me fye së besoj jeni tu na bë nderë, së mos me kanë Agim Veliu e Sami Lushtaku, Vetëvendosja si kish marr 50%, vazhdoni me na fye, po kallëzoni kuvendit komunal po edhe qytetarëve së ju nuk bëni me fye atje pa na kallëzua neve qysh vazhdoni me fye Albin Kurtin për dështimet tuaja. Tjetra, çka ka me bë komuna për tri raste të hapur nga institucionet që janë në polici, prokurori, për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm për shkak të pa përgjithësisë së komunës, çka ka mu bë këtë duhet me ditë, me na tregua, së jo me kalua këtë fushë që s'ka ndodhë? Çka ka me ndodh qysh ka me u trajtua rasti kur kryetari i komunës që i thotë vetit kryetar ka me shkua në gjykatë me fol kundër komunës, MAPL thotë është në interes të komunës që një pronë me ju kthye për 35 viteve, kryetari thotë jo nuk është në interes të komunës për 35 vite, po për 99 vite duhet me ja dhënë privatit, pra ven së me mbajt interesin e komunës ka me shkua me mbajt interesin e privatit. Tjetra, çka ka me ndodh me vendimin e MAPL-së që thotë kryetari i komunës ka dal kundër mandatit tina, duhet me na tregua, nuk mundem me fol na për planin e punës, e ka në vendim të MAPL-së, thotë; nuk është në kompetencat e tij. Në këtë plan punë është edhe arsimit po e lexoj jo çka po them unë po çka po thotë inspektori i inspektoratit të arsimit në vendimin që e ka lëshua me 27.11.2023 thotë; Në gjimnazin Hamëz Jashari në Skenderaj, inspektorët e arsimit nuk arritën të konstatojnë sak numrin e nxënësve në klasat e 10 ta, si dhe a janë respektuar kriteret e konkursit në lëndet prioritare për drejtimet përkatëse, si dhe në pikat e testit të arrishmërisë sepse mungojnë emrat e nxënësve të regjistruar në librat e klasave si dhe mungojnë dëftesat e nxënësve, po flasim dy muaj masi që ka fillua viti shkollor, nxënësit nuk janë regjistruar, e po flasim për plan të punës qysh ka mu bë arsimit i mirë. Thotë, raporti i inspektorit, drejtoresh e gjimnazit është zgjedhur dikush që i ka dy muaj përvojë punë, është punësuar dikush sekretare e shkollës pa e ditë në cilën shkollë, veç së është pjesë e familjes së kabinetit të kryetarit. Tani thuhet lejet e ndërtimit në DU, na merr pak kohe, po ne a jemi kanë këtu, e dina që lejet e ndërtimit janë lëshuar për një ditë, a e dimë ne që komuna është tu ndërtua pa leje. E drejtorja e dallavereve drejtorja e Bujqësisë ka me së paku të shënuar diçka, sepse duhet pak, për me bë dallavere shume. Ky plan i punës i ka dy të meta të mëdhaja të cilat ju sugjerojë me i përfshi, 1. Trafikun publik që komuna duhet me marr përsipër neper fshatra, në të kundërtën qysh tha edhe Halil Xani në një postim, një banës në qytet një fshat i zbrazur, dhe 2. Zgjerimi i kanalizimit sepse për ndryshe qyteti ka mu përmyt çdo vite?

Sala Jashari-E PAVARUR: Atëherë prej gjitha drejtorive kam dashur me i prek disa pika të shkurtër të cilat i sjelli si sugjerime për me ndryshua për komunën e Skenderajt, pavarësisht pjesëve që e shohim që ka disa mangësi, po shpresoj që ta sjellim një mundësi të re në këtë komunë, ku do të jetë përfundimi, cilat janë rezultatet e mundshme kështu që po nisna me Drejtorin e zhvillimit ekonomik; me ka pëlqyer shume një prej pjesëve ku e keni cekur; Mbështetjen e të rinjve me angazhime praktike në punë dhe trajnime në punë në institucione dhe biznese dhe përmes kësaj e shprehi gatishmërinë time për të ndihmua në këtë aspekt. Sa i përket Drejtorisë së arsimit, në një seancë të kaluar e kam përmend së jam pjesë e një organizate që e ka një rrjetë global dhe e kemi

krijua një instrument të vlerësimit të mësimdhënësve në vitin 2024, ju e keni parapa që dëshironi ta bëni vlerësimin e mësimdhënësve duke i ndërlidhur edhe prindit, dhe e shohë shumë të nevojshme që të bëhet një bashkëpunime me këtë organizatë ti sjellin këto instrumente, dhe janë thënë që ti sjellin falas në komunën e Skenderajt, në këtë organizatë i kemi 5 persona që janë nga komuna e Skenderajt, një nder to e kemi edhe Getoarben që punon në komunë, dhe besoj që përmes këtyre instrumenteve të bëhet vlerësimi i mësimdhënësve, dhe ju kisha sugjerua me ftua organizatën në takim dhe me ndryshua pak të kjo pjesë. Kisha dashur me shtua të aktivitetet që i keni përmend, mësimi shtesë, që e keni përmend vetëm për një kategori të caktuar, dhe unë mendoj që duhet me u shtua edhe një diçka tjetër me u hartua një plan që ngjanë pak a shume me këtë formë, p.sh. Mësimi shtesë nëse nuk mundet me u krye prej mësimdhënësve aktual mundet me kanë një plan kështu; p.sh. Nxënësit e shkollës së mesme nëse kishin mundur me ja mësuja pak a shume pjesën vullnetare ata munden me jap mësim shtesë për nxënësit e shkollës fillore prej klasës I deri 5 mësim shtesë dhe komuna mundet me i certifikua me i mbështet këta nxënës për punë vullnetare që janë tu e bë. Edhe është shume e rëndësishme që shkollat publike me pas një Plan konkret në raste emergjente, dhe unë nuk kam informacione që shkollat në përgjithësi dinë qysh me u qas në momentin që ka një termet ose zjarr, p.sh. Kush del i pari prej dere dhe a ka me u krijua panik. Të DKRS-së i pash aktivitetet që i keni përmend, po dua me u ndërlidh të beteja e 5,6 dhe 7 Marsit, sipas meje kjo beteje këto data që po festohen, me herët e ka pas një ndjenjë edhe një volum shume me të madh si viteve të fundit e çka po shpresoj unë prej kësaj po dua me u sugjerua që me u krijua një grupe punues tu u nis prej krejt asamblistëve me bë një planë konkret që me ja propozua qeveris që me ndikua që me rritë volumin dhe identitetin e kësaj beteje në komunën e Skenderajt, i kemi tri aspekte që mundet me ndikua pozitivisht nëse ne ndryshojmë diçka të mirë; Po bëhet ruajtja e historisë, po kultivojmë hala rendësin e kulturës, edhe njëkohësisht po e shtojmë edhe turizmin.

Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, para së ti bëjë pyetjet e mija për ekzekutivin, kisha dashur me përgëzua kolegun nga radhët e LVV, për nivelin e lartë të hipokrizisë që e ka. Pyetje për DUMA-së, Drejtor a bënë me na sqarua për banoret e fsh. Burojë, kur pritet me përfundua në tersi projekti i ujësjellësit? Pyetje për Kryetarin, kryetar për investime në BL - Turiqecit, çka pritet të realizohet gjatë këtij viti, për fsh. Kopiliq i Poshtëm, Kopiliq i Epërm, Vajnik, Burojë dhe Turiqec, duke pasur parasysh së ka ende probleme si në kanalizim, trotuar, ndriçim për së cilin këtyre fshatrave, pra cilat janë planet për këtë vite, pasi që kërkesat e shumta të banorëve të këtyre fshatrave nuk mungojnë si në drejtimin tim si këshilltare komunale ashtu edhe në drejtim të ekzekutivit? Dhe rruga Ejup Halit në fshatin Kosterrc a është në planë për asfaltim në këtë vite?

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, unë i kam dy kërkesa për kryetarin edhe për drejtorin e arsimit, drejtor të shikohet mundësia që të bëhet çmos së paku në shkollën e qytetit shkollën Ahmet Delija të realizohet ndërtimi i sallës sportive, e kam cek edhe disa herë edhe privatisht që një shkollë që i ka afër 1000 nxënës dhe ka rezultate jashtëzakonisht të mira, që fëmijët me loz në bari dhe në lloq nuk është korrekt dhe ja vlen, pasi që qeveria e këtij mikut të LVV i ka hekë nga sistemi po së paku komuna të bëjë përpjekje dhe të rregulloj? Për DKRS-së, mundësisht jam ithtar që në vitin e ardhshëm të gjenden forma dhe mjete të bëhet edhe ndërtimi i një bibliotekë të qytetit, dhe mendoj që këtij qytetit i duhet dhe i vyen një bibliotekë?

Afrim Kabashi-NSD: Për Drejtorin e Administratës: Ne planin e punës te drejtoria e administratës ku ceket bashkëpunimi direkt me ministrin e administratës publike dhe agjensionin shtetëror te informacionit për avansimin e sistemeve ne përputhje me politikat qeveritare për teknologji informative? Pyetja është a keni bashkëpunim siç ceket me MAP/ASHI, dhe cilat janë sistemet qe duhen te avancohen? Për Drejtorin për Urbanizëm; Drejtor ne planin e punës te ekzekutivit për

vitin 2024 nuk e pashe ne projektin e vazhdimet te punimeve ne rrugën e nisur Polac -Dashefc, si do te jete arsyetimi nga Ana e juaj para banoreve te atij lokaliteti, e kure dihet se projekti i kësaj rruge ka qene I paraparë ne planin e qeverisjes suaj 2022-2025,dhe a mos do ta kenë fatin e njëjte edhe disa projekte te parapara për ketë vite për realizim sikurse kjo rruge?. Dhe pyetja tjetër drejtor a keni ne plane te përfundimit te punimeve te kanalizimit ne disa lagje te fshatit Polac, apo do te mbesin ne letër, si projekt ne realizim dhe do ta këtë fatin e pritjes se qeverisjes te ardhme pasi qe atë fate te pritjes e ka nga 2013/14. Tek Drejtoria e Bujqësisë kam një pyetje; Ne raport te punës për vitin 2024 kishe ceke monitorimi i grandeve te shpërndara nga DBPZHR nga vitet paraprake. Drejtor a mundesh me na informua konkret a i keni drejtua këto grande tek fermerët qe merren direkt me bujqësi, apo te militantet partiak, dhe a mundesh te na informosh a do te vazhdojmë me praktiken e selektimeve ne baza partiake e qe ma merre mendja pa dashje nga cili krah politik vjen nuk i shërbejnë prodhimitarisë bujqësore qe është bazamenti kryesor i fuqizimit te ekonomisë shtetërorë? Për Drejtorin për Shëndetësi; Drejtoresh te admiroje për planin dhe qëllimet e sektorit tuaj për vitin 2024 qe I lexova ne raportin tuaj. Pore diçka qe me ra ne sy gjate leximit te këtij raporti mos futja ne projekt te renovimit apo rehabilitimit te AMF-se në Polac ku shume mire besoj ti e dine mbi gjendjen momentale te saje nëse e ke vizituar?.

Abdulla Gashi-IDEAL: Pyetje për drejtorin e urbanizmit, dhe drejtorin e inspektoratit:

Ndërtimet që janë duke u bere nga kompania “Andrra” rruga Ahmet Delija, a keni ndërmarre diçka për parandalimin e shkatërrimit te pronave publike e private, ku kjo kompani është duke vazhdua pa leje te ndërtimit? Drejtor a keni ndërmarre ndonjë mase me e ndalu apo jeni duke i ndihmo kësaj kompanie? Kjo kompani qe dy raste është duke e rrezikuar sigurinë e qytetareve nëpërmjet ndërtimit pa kurrfarë kriteri dhe sigurie: çarja e rrugës, çarja e shtëpive private - janë demet që janë shkaktuar nga kompania “Andrra”.Për vitin 2024 a keni vendosur për me i ndihmo këto kompani shkatërruese te pronave publike e private, te grupeve te interesit te kësaj qeverisje?

Pyetje për drejtorin e urbanizmit Driton Mula: Ne planin e punës ne fshatin Polac keni parapare shtrirjen e kanalizimit për të cilin ju keni deklarua me herët qe ne fshatin Polac kane përfunduar kanalizimet. Drejtor, a keni paraparë rregullimin e kanalizimit përballë memorialit ne Marine, ku ky kanalizim është duke i infektuar tokat dhe pusët me ujë te pijshëm? A keni parapare që banoret e fshatit Kryshec, Marine, të kenë ujë të pijshëm, sepse janë në gjendje te mjerueshme, që 24 vite pas lufte këto fshatra ende nuk kane ujë të pijshëm, me të vërtete kjo është e turpshme.

Drejtor, në fshatin Polac, Kryshec, Marine, Dashec, a keni parapare rregullimin e trotuareve?

A keni parapare ndriçimin e rrugëve neper këto fshatra, këtë pyetje pa ta bej për bashkësinë lokale Polac, por kjo vlen edhe për te gjitha bashkësitë lokale të komunës së Skenderaj-it.?

Pyetje për drejtorin e Arsimit Kastriot Duraku: Drejtor në planin e punës për vitin 2024 a keni parapa diçka rreth rrezikut dhe sigurisë për jetë që jon te rrezikuar nga qenet endacak, Drejtor a keni parapa diçka rreth shkollës në Marinë ku në këtë shkolle nxënësve ju mungon gjeja me elementarë si qeshte uji i pijshëm, në ketë shkolle nxënësit rrezikohen nga ndonjë ne epidemi qe vjen ne mungesa higjienikë, në WC nuk ka ujë për pastrim nuk as qeshmë qe jon ne gjendje të mjerueshme, a keni parapa diçka për sigurinë e nxënësve qe jon te rrezikun nga shembja e gurëve qe e kam diskutua ne disa seanca kërkoj nga ju te intervenoni sa ma shpet sa nuk është bërë vone.

Naser Bajraktari- IDEAL: E kam shikuar planin e punës, po desha pak të DBPZHE-së se e pash një plan pa plan, dhe nuk pash në atë plan as një sene për vitin 2024, që do ti mbështet fermerët. Drejtor a mund me na llogarit sa e ke zvogëluar koston të prodhimit të atyre prodhuesve të cilat ju keni dhënë mjete bujqësore? Unë e di që mjetet bujqësore nuk i keni dhënë për bujqit i keni dhënë për militantet e juaj, për ata që i kanë ka 10 ari tokë, e nuk i keni dhënë atyre që i kanë ka 20 h tokë. Në vend që ti sot drejtor me na sjell një raport që i kemi votua dy projekte që i

kemi dhënë mjete, me na raportua, e ti e ke mbështet njërin në sektorin e pemëtarisë, dhe sa i përket sektorit të pemëtarisë e arra që i ka dhënë ministria edhe ju me miliona e nuk ki ku me ble një kg arra, leni këto lojna po ndihmoni bujkut drejt, subvenciononi bujkun të cilët janë bujkmos i subvenciononi neper banesa. Unë e di drejtor që nuk je profesionist për këtë punë, po je profesionist për tjera sene, nuk je ka e zhvillon bujqësinë, po je ka e degradon.

Besiana Thaçi-PDK: E pata një pyetje për Abdullahun, para disa seanca u krenojshqe qysh Bekim Jashari e ka shpërnda ujësjellësin në çdo fshat të Drenicës, e tash e përmende një fshat që nuk ka ujë të pijes edhe the është e turpshme. Tash pyetja ime është: a ka punua Bekim Jashari, a nuk ka punuar diçka në këtë komunë para 4 viteve? Për Hysin, ja bëra një koment e vlerësova nivelin e lartë të hipokrizisë që e ka, nuk bëri zë, po me duket i pëlqej si shume, pyetje është, kur foli për Albin Kurtin, a foli për Albin Kurtin e opozitës, a foli për Albin Kurtin e pozitës tash?

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Abdulla Gashi-IDEAL: Besiana qeveria e Bekim Jasharit i ka bërë 24 fshatra me ujë të pijes.

Musa Fazliu-IDEAL: Për drejtorinë e Bujqësisë për subvencione që janë dhënë, ka raste ku njërit me 30m2 oborr i jepet subvencione e njeri që i ka 12 ari oborr nuk i jepet subvencione, edhe ka njërit që është në banës i shpërndani subvencione dhe e qet e shet mjetin, kjo nuk është në rregull drejtor.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Fikret Rexhepi-PDK: Fjala përshëndetëse, Hys, kur nuk po të bie mirë diçka, po thua thmij të lazduar, kështu është mirë tash me na mbajt ligjëratat qysh po na mban çdo seancë që po del përpara si me kanë profesor. Edhe diçka tjetër desha për drejtorin e bujqësisë, koleg të nderuar, folni kotë, së prej krejt drejtorëve, drejtor ma i mirë është Bexheti, edhe unë e di që Naserit i ka mbet merak me kanë drejtor i bujqësisë, po nuk ka mundur me arrit atë qëllim. Edhe një pyetje për DUMA-së, subqendrat në fshatin Qirezë kur kanë me fillua punimet?

Besiana Thaçi-PDK: Nuk mundem me pushua e qetë nëse nuk e dëgjojmë këtë video të Albin Kurtit, si në vijim: (Qeveria e Kosovës e ka krijuar përshtypjen që po zhvillon që po e zhvillon, e po e ndihmon Drenicën shumë, mirëpo komuna e Skenderajt është komuna me nivelin me të lartë të papunësisë në Kosovë plotë 67%, dhe nderë komunat me të varfra në Kosove. Nëse kështu po e ndihmon qeveria e Kosovës Skenderajn, besojë që Skenderaj shumë me mirë ja del pa ndihmën e qeveris së Kosovës). Pajtona me fjalinë e fundit që tha Albin Kurti i opozitës që Skenderaj ka me ja dal edhe pa ndihmën e qeveris.

Kryetari i Komunës z.Fadil Nura: Faleminderit që dhatë kontribute ashtu qysh dite e sa ditë, po disa rekomandimet dhe kërkesat si të Sales kenë shume profesionale dhe besoj që drejtori i arsimit ka me i pas parasysh. Po ashtu edhe kërkesat e Besatit që i patë disa kërkesa shume të nevojshme për salla të sportit, dhe është prioritet i joni dhe do të gjejmë forma që me ndërtua një salle sportive në atë shkollë, po dhe të bibliotekës e kemi në programin dhe jemi në fazën e hartimit të një projekti të muzeut dhe bibliotekës së qytetit dhe sipas planifikimeve kemi me fillua me realizua vitin e ardhshëm. Disa kërkesa kenë për drejtoret, diçka tjetër nuk kam.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (1) abstenim miratohet Plani i Punës i Ekzekutivit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2024, me Nr.02-112/01-0063732/23 të datës 21.12.2023.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për Nismën e Kryetarit të Komunës së Skenderajt për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar (binjakëzimit), me Komunën e Tuzit të Malit të Zi, me Nr.02-053/07-0061502/23, të datës 07.12.2023, (Raporton)

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura; Fjala përshëndetëse, para vetes e keni një Propozim-vendim për Nismën e Kryetarit të Komunës së Skenderajt për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar (binjakëzimit), me Komunën e Tuzit të Malit të Zi, që ka rrjedh nga kërkesa e komunës e Tuzit që na ka drejtua përmes kanaleve zyrtare ambasadës së republikës së Kosovës në mal të zi e në të njëjtën kohe kemi kontaktuar me kryetarin e komunës së Tuzit, që kemi të përbashkët si komuna, si histori si vlera kulturore, turizëm.

Kryesuesja; Faleminderit, e hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, ne këtë propozim vendim e përkrahim po ju kisha lut që mos bëni si në rastin e binjakëzimit me komunën e Kroacisë, ku në emër të historikut keni shpenzuar aq shume para sa që keni paguar edhe mëditje, dhe kisha kërkuar nga ju që të ketë barazi dhe mos të ndodhin gjërat e njëjta që kanë ndodhur atje.

Afrim Kabashi-NSD: Edhe unë e përkrahi këtë propozim vendim dhe me sa po muaj ta kuptojë përveç historikut që është një bashkëpunim që është në kontestin e vlerës dhe historisë, desha t'ju pyes kryetar se ne kuadër të propozimit për të hyrë në bashkëpunim komunal apo binjakëzimit a ka diçka kjo marrëveshje diçka në aspektin ekonomik apo mërqinjës sociale.

Musa Fazliu-IDEAL: Kryetar ne e dimë që binjakëzimi është i mirë, mirëpo a mundesh me na tregua ma gjerësisht së çfarë të mirash po na sjell ky binjakëzim?

Kryesuesja; Faleminderit, fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura; Ajo që është e rëndësishme kjo marrëveshje bëhet për histori për vizita tradicionale të kulturës, dhe çoftë të ndonjë marrëveshje të zhvillimit ekonomik.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati për këtë pike, shkojmë në votim konstatojmë me (20) vota për, (7) kundër dhe (1) abstënim miratohet Propozim-vendim për Nismën e Kryetarit të Komunës së Skenderajt për të hyrë në bashkëpunim komunal ndërkombëtar (binjakëzimit), me Komunën e Tuzit të Malit të Zi, me Nr.02-053/07-0061502/23, të datës 07.12.2023.

Vazhdojmë me piken 7 të rendi ditës:

-Raporti i punës së Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023, me Nr.02-112/01-0063718/23, të datës 21.12.2023, (Raporton);

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura; Para jush e keni Raportin e punës së Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023, ky raport ka të bëjë me UA, që na obligon me sjellë raport në kuvend që me raportua sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të KKSB-së, që ka qenë shume funksional dhe një bashkëpunim shume i mirë më të gjithë akterët të këtij këshilli, janë nxjerrë disa rekomandime janë nxjerrë disa vendime, po këtu në raport nuk i kemi cekur krejt detalisht.

Kryesuesja; Faleminderit, e hapë debatin fjalën ja kaloj:

Osmani Smajli-IDEAL: Fjala përshëndetëse, kryetar sa i përket këtyre raporteve, a i keni bërë veç sa me i qitë në letër, apo a keni ndërmarrë diçka si p.sh. rreth qeneve endacak dhe të ekspozimi i mjeteve piroteknike, për arsye të festave të fund vitit?

Hysni Mehani-LVV: Parimi i raportit duhet me pas të vërtetën, ky raport nuk është i vërtetë, këtu thuhet: Parimi kryesor dhe i përhershëm i KKSB-së është bashkëpunimi me të gjithë akterët të cilët ndihmojnë në çështjen e sigurisë si dhe me EVSB-të dhe KLSP-te, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet me synim të zgjidhjes konkrete të problemeve duke përfshirë edhe ato që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi. D.m.th. as njëri përfaqësues të KLSP-ve përjashtoi Agron Kajtazin, që dinë me notua ka të sille ujë, nuk është lejua me qenë pjesë të mbledhjes, a është kështu, me vendim tuaj, ju keni propozua e keni qitë në votim i keni përjashtua krejt KLSP-në, dhe ndërkohe këtu po thua na bëjmë bashkëpunim e ti e ke përjashtua KLSP-në.

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura; Hysni a e ke lexua UA, së qysh zgjedhën anëtarët, kush i zgjedh, po ke ardhur me informata të mangëta që ti kanë dhënë disa akterë të pa rëndësishëm për

këtë kuvend, hajde pak i përgatitur, nën ombrellën e kujt funksionojnë anëtarët, së përfaqësi i KLSP-ve për herë të parë është në këtë formë që jam tu e udhëheqë sepse janë kanë të pa formuar dhe nuk e kamë përjashtuar askënd, e kam përjashtuar një zyrtar policor që ka ardhur i pa autorizuar i pa zgjedhur dhe ai nuk ka të drejtë me marrë pjesë në atë formë. Sa i përket qeneve endacak dhe mjeteve piroteknike ke të drejt, nuk kamë qenë në mbledhjen e fundit ka qenë drejtori i përhershëm që e ka udhëheq këtë mbledhje, qenët endacak janë një problem rajonal, që e kemi diskutuar disa herë, e kemi një marrëveshje me një organizatë zviceranë që po i vaksinonjë, po problemi qysh thotë ligji nuk mundem me marr atë përgjithësi, pa kanë ndonjë strategji nga niveli qendror dhe me bë ndonjë zgjidhje të përhershëm.

Kryesuesja: Faleminderit, fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Unë e di që ti këtyre ju bërtet e ju tregon çka me fole, po të unë nuk funksionon ajo. Po a kanë mëm tregua a janë përfaqësuesit t KLSP-ve, edhe përfaqësuesit e EVSP-së të pranishëm në KKSBB-së,?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Besart Rrecaj-PDK: Dëgjo koleg së me qite pak prej reni, po nëse të themi ndonjë fjalë jo të mirë mos u prekë, sigurisht niveli i debatit tënd është për keqardhje, është turp është marrë, në qeverisjen e kaluar ti kanë pas dredhua do gishta e ti ka drejtuar Nexhat Ahmeti, tash që dy vite e fyen kryetarin, nënkryetarin, drejtor, asamblistë. Me i thanë kryetarit të komunës ju bërtet, është gënjeshtër e pastër edhe e turpshëm, është rren e kulluar.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura: Është një strukturë e policisë në KKSBB, e përzgjedhin në kuadër të stacionit që me herët i ka përfaqësuar vet komandanti i policisë, nuk e kam përjashtuar askënd, dhe që as nuk e përjashtoj askënd. Unë kam me shume së ju përvojë parlamentare, dhe ju kisha lutë prej të gjithëve që me ruajt gjuhën e komunikimit dhe me respektuar këtë institucion, më kritikua mua me bëni nderë nëse me ofroni bazë dhe kritiken e pranoj si të mirëqenët, sepse të gjithë ju e përfaqësoni dikë këtu në këtë kuvend.

Kryesuesja: replikë 1 min.

Hysni Mehani-LVV: Mua askush në jetë nuk mi ka dredhua gishtat në këtë kuvend, ka pas presione, po me mi dredhua gishtat jo, Nexhat nëse i ke thanë dikujt që mi ke drejtua gishtat qu trego, po gishtat nuk mi ke drejtua Nexhat. Unë u quajta këtu që po flas hipokrizi, po hipokrizi flet hipokriti, po për besë mendoj që jam absolutisht brenda gjuhës parlamentare, dhe kurrë nuk fye, po këtu shkon niveli i urrejtjes ndaj meje deri në nivelin patologjikë, po kritiken kurrë s'ka me ndal sa të kam bazë për kritik.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati për këtë pike, shkojmë në votim konstatojmë me (16) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim përkrahet Raporti i punës së Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2023, me Nr.02-112/01-0063718/23, të datës 21.12.2023.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës:

-Informatë lidhur me vendimin e kuvendit Nr.01-112/01-0050960/23, datës 29.09.2023, Raporton)

Kryetari i Komunës z. Fadil Nura; Informatë lidhur me vendimin e kuvendit Nr.01-112/01-0050960/23, të datës 29.09.2023, për hire të transparencës e kemi procedua në kuvend për me qenë të informuar, nuk do të thotë me qenë edhe me shkrim, së informata bëhet edhe gojarisht për vendimin për ndryshimin e organogramin e komunës, MAPL-ja e ka kthyer pas 15 ditësh, dhe ne e kemi implementua dhe jemi në rregull dhe kjo ishte me e rëndësishme me njoftua kuvendin.

Kryesuesja: Faleminderit kryetar, e hape debatin nëse nuk ka Konstatojmë me (16) vota për, (3) kundër dhe (0) abstenim përkrahet Informatë lidhur me vendimin e kuvendit Nr.01-112/01-0050960/23, datës 29.09.2023.

Vazhdojmë me piken 9 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e vendimit për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2024, me Nr.01-463/01-0062208/23, të datës 13.12.2023, (Raporton)

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Fjala përshëndetëse, para vete e keni Propozim-vendim për miratimin e vendimit për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2024, kjo listë është e hartuar si obligim ligjor që rrjedh nga neni 13 i ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës si dhe rregullores që, nuk e kemi obligim me sjelle këtë listë në kuvend, po për hire të transparencës e kemi sjellë, listën e keni para veti, ju ftojë me përkrah.

Kryesuesja: Faleminderit, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: E nderuara drejtoresh kam kërkesë që kur të na bini pika për pronë, që në këtë legjislativë që 2 vite që kemi që kemi është praktik nga ana e juaj të na bini në çdo seancë, krahas numrit të parcelës të na ofroni foto si dhe informata më të qarta se ku gjendet ajo pronë dhe destinimi i sajë, e jo me u bazuar me hy në gjëportal e me shikua se ku gjendet ajo pronë e në të shumtën e rasteve dalin jo konkrete dhe jo të qarta ofroni të dhëna konkrete që të dimë çka votojmë apo çka mos të votojmë. Dhe kam pyetje konkrete a kemi ndonjë interesim të investitorëve që kanë shprehur interesim me investimet në këto pronë që i kemi në listën që e kemi prua në kuvend për votim.

Hysni Mehani-LVV: Kur të bini parcela dot duhej me ditë së ku gjenden këto pronë, me pas foto se nuk po e dimë ku gjenden këto pronë në këtë listë.

Musa Fazliu-IDEAL: Drejtoresh masi të nuk u kanë arsyeshme me i prua këtë listë në kuvend, atëherë pse e bishe, pse po na merr kohe, mirëpo veç ishallah po ngini e nuk ju jesin në fyte këto pronë, së qysh ja keni nis edhe pronat të shpija keni me fillua me na marrë që na kanë lanë dem baba dem.

Osman Smajli-IDEAL: Drejtoresh a mundesh mëm tregua për pronën 244-0, në ZK-Turiqec, a e din ku është kjo pronë, edhe çfarë interesi ka komuna në atë pronë?

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Siç e keni pa kjo është vetëm listë e pronave që na obligon ligji me nxjerr, është e cekur numri i pronës, sipërfaqja, edhe ZK, ku gjendet, kështu e kërkon ligji, nuk kërkon foto së ku gjendet pronë në këtë pjesë. Komuna e Skenderajt i ka diku 1000 pronë, mirëpo këto 34 pronë i kemi pa bashkë me kryetarin dhe me drejtorin që janë me të përshtatshme që mundet me u interesua dikush me marrë për investime, dhe kjo listë është fazë paraprake, kur ka interesim dikush për ndonjë pronë që gjendet në këtë listë ju sjellim foto së ku gjendet pronë me datajshë. I nderuar zonën katastrale po e sheh, sipërfaqen po, numrin e parcelës po, ajo pronë është pronë bujqësore dhe është për zhvillim ekonomik, për interes të qytetarëve.

Floriana Halili-LVV: Drejtoresh edhe unë desha më të pyet për disa ngastra në këtë listë, së ku gjenden, po masi nuk po i dinë nuk po të pyes hiq.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (12) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e vendimit për publikimin e listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2024,

Vazhdojmë me piken 10 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e vendimit paraprak të vendimit për ndryshimin e kufirit të Zonës Kadastrale Llaushë-Skenderaj, duke bërë bashkimin e ngastrave nga ZK-Llaushë, në ZK-Skenderaj, me Nr.02-350/04-0062272/23, të datës 13.12.2023, (Raporton);

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci; Para jush është Propozim-vendim për miratimin e vendimit paraprak të vendimit për ndryshimin e kufirit të Zonës Kadastrale Llaushë-Skenderaj, duke bërë bashkimin e ngastrave nga ZK-Llaushë, në ZK-Skenderaj, për ngastrat në ZK- Llaushë në ZK-Skenderaj, si me poshtë: Parcelat kadastrale me numër 1368-5 më sipërfaqe prej 200 m², dhe parcela numër 682-8 më sipërfaqe prej 439 m², ZK-Skenderaj, në pronësi të Isuf (Behram) Gashi. -Parcelat kadastrale me numër 1366-1 më sipërfaqe prej 608 m², dhe parcela numër 1367-1 më sipërfaqe prej 2065 m², ZK-Llaushë, dhe parcela numër 682-9, dhe 930-0 ZK-Skenderaj në pronësi të Ibush (Behram) Kabashi. -Parcela kadastrale me numër 1368-1 më sipërfaqe prej 656 m², ZK-Llaushë, në pronësi të Sanie Hyseni, -Parcela kadastrale me numër 1368-3 më sipërfaqe prej 650 m², ZK-Llaushë, në pronësi të Shaip Thaqi, ky bashkim bëhet sipas kërkesë së banorëve dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MMPH) Nr.09/2019. Me miratimin e këtij vendimi dhe kalimit të afatit të shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, vendimi bashkë me kërkesën e banorëve do të dërgohet ne Agjencionin Kadastral të Kosovës për miratim përfundimtar.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (9) kundër dhe (1) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e vendimit paraprak të vendimit për ndryshimin e kufirit të Zonës Kadastrale Llaushë-Skenderaj, duke bërë bashkimin e ngastrave nga ZK-Llaushë, në ZK-Skenderaj.

Vazhdojmë me piken 11 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), për Komunën e Skenderajt, Nr.09-112/01-0061908/23, të datës 11.12.2023, (Raporton)

Drejtori për DSHP-së, Alban Shala; Fjala përshëndetëse, propozim-vendim për miratimin e Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), për Komunën e Skenderajt. Qëllimi i Planit Operativ Emergjent Lokal, është që të përshkruaj ato aktivitete që do të ndërmerren nga ana e qeverisjes komunale dhe zyrtaret të tjerë të komunitetit për të mbrojtur jetën dhe pronën e qytetareve në raste të një fatkeqësie natyrore ose të shkaktuar nga faktori njeri, duke përfshirë terrorizmin, emergjencat ose fatkeqësitë si dhe nevojat e menaxhimit emergjent.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (5) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për miratimin e Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), për Komunën e Skenderajt, Nr.09-112/01-0061908/23, të datës 11.12.2023.

Vazhdojmë me piken 12 të rendit të ditës:

-Raporti i Monitorimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, për vitin 2023, me Nr.12-052/01-0062576/23, të datës 14.12.2023, (Raporton);

Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi; Fjala përshëndetëse, ky është një raport statistikor të cilin ne, në baza vjetore e dërgojmë të MAPL-ja, po ketë vite të njëjtin informacion është kërkuar të sillet në kuvend. Kjo përfshin kryesisht statistikatat të realizimit të projekteve, prioritetet kryesore të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023, ka qenë krijimi i një ambienti me të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin dhe mbështetjen për sektorin lokal ekonomik dhe promovimi i mundësive. Ky raporte përfshin 13 objektiva dhe 63 projekte që përfshin fusha të urbanizmit, zhvillimin e bujqësisë, zhvillimin publik, arsimit dhe kultura, shumica e projekteve janë rrjedhimisht të vitit 2019-2023 që janë kryer me herët ose janë në vazhdim ose kanë përfundua këtë vite. Nga 63 projekte janë kryer 28 projekte, 15 janë në proces, 20 të tjera ende nuk kanë fillua, kjo informatë është për herë të parë në kuvend është kërkesë e MAPL-së të jetë në këtë formë.

Kryesuesja: Faleminderit, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Drejtoresh në baze të planit punës për vitin 2024 ju si drejtoresh keni një mision të papare deri me sot në një qeverisje komunale, si po duket projekti i vetëm i zhvillimit

ekonomik është rehabilitimi i militanteve të PDK-se, Me pake fjale drejtoreshe ju do mbaheni mend vetëm për një projekt të vetëm deri me sot në këtë drejtori, funksionalizimin e kësaj drejtorie me militant dhe aktivist të PDK-se. Unë me kanë në vendin tuaj nuk e kisha quajtur ma Drejtori a për Zhvillim Ekonomik dhe Inovacion, por e kisha ndërruar emrin si "Drejtoria për rehabilitim e militanteve partiak të PDK-së.

Hysni Mehani-LVV: Me vjen keq për Besartën, Besarta ka qenë kundër kësaj drejtorie, tash është tu punua me arsyetua këtë drejtori, po për besë ky veç raport nuk është, kisha prit një raport më të detajuar, po dihet je tu e mbajt një drejtori për me i mbajt do vena të punës së nuk ka mbet diçka tjetër aty.

Drejtorja e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi: Jam ka flas për disa për disa informacione statistikore që përfshin strategjinë për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023, që ka të bëjë me gjitha drejtorit të komunës të cilës këtë vite i përfundon afati, dhe besoj që seancën e ardhshme do të kemi një draft të strategjisë për zhvillim ekonomik, dhe ka të bëjë me gjithë komunën me gjitha drejtorit, nuk ka të bëjë veç me drejtorin time.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (9) kundër dhe (1) përkrah Raporti i monitorimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2019-2023, për vitin 2023, me Nr.12-052/01-0062576/23, të datës 14.12.2023.

Vazhdojmë me piken 13 të rendit të ditës:

-Propozim-Vendim Për miratimin e Raportit Përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga era dhe fatkeqësitë tjera në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023 me Nr. 02-020/01-0065420/23, i datës 28.12.2023, (Raporton);

Drejtori për DSHP-së, Alban Shala; Para jush e keni Propozim-Vendim Për miratimin e Raportit Përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara kryesisht nga era dhe fatkeqësitë tjera në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023, janë shkaktuar 68 raste të dëmeve nga këto fatkeqësi në vlerë prej 172,407.21€ ju ftojë me përkrah këtë raport të komisionit që është formua me vendim të kryetarit.

Kryesuesja: Faleminderit, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Naser Bajraktari-IDEAL: Drejtor edhe në seancën e kaluar e kaluar e kemi diskutua, dhe të kam thënë, dhe po ta them prapë, pse nuk po i bini të dhënat kush janë këta persona, pse nuk po e specifikoni me detajisht, sa ferma janë dëmtuar, sa sera, pse kur ti kërkosh paret nuk je i saktë, drejtor je shumë i pa qartë në këtë raport.

Abdulla Gashi-IDEAL: Drejtor a është reale vlerësimi i këtyre personave nga demet, nga çfarë vlerësimi e keni bë demet në teren, me na specifikua me kuartë drejtor?

Hysni Mehani-LVV: Në një seancë të kaluar drejtor, me ke premtuar me mi dhënë emrat e atyre që kanë qenë përfitues, të kam thirr edhe në telefon, me ke thënë po, edhe nuk mi ke dërgua emrat.

Afrim Kabashi-NSD: Edhe unë jam kanë i dëmtuar prej këtyre dëmeve, komisioni ka qenë të unë për vlerësim të dëmeve, nuk ju kam përzi komisionit, se di qysh me kanë vlerësua, dhe për këtë që jam i dëmtuar do të abstenoj për këtë pikë.

Drejtori për DSHP-së, Alban Shala; Këshilltar t' kam thënë edhe po të them prapë, kjo listë e vlerësimit të dëmeve shkon në komisionin qendrorë, dhe komisioni qendrorë për çdo dyshim del në teren për verifikim, dhe ky komision komunal jam i sigurte që e bënë punën sa ma profesional, dhe pa ndikim ndaj askujt. Qoftë së dyshoni së ju ka bë dikujt pa drejtë në vlerësim, keni drejtë me bë kërkesë në qasje në dokumente. Hysni e di që me ke thirrë në telefon, dhe tu kam përgjigje pozitivisht, po të ftoj me ardhur në zyre.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (16) vota për, (8) kundër dhe (4) miratohet Propozim-Vendim Për miratimin e Raportit Përfundimtar, të komisionit për vlerësimin e dëmeve

të shkaktuara kryesisht nga era dhe fatkeqësitë tjera në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2023 me Nr. 02-020/01-0065420/23, i datës 28.12.2023;

Vazhdojmë me piken 14 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Pyetje për: Kryetarin e Komunës, a është duke u zbatuar kodi i etikës nga zyrtarët e komunës dhe apo monitorohet nga Komisioni i kodit të etikës i cili është themeluar nga ky Kuvend? Pyetje për kryesuesin e komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve për Komitete Konsultative; A po mbajnë komitetet konsultative mbledhje, nëse po, a po punojnë për ndonjë rekomandim për të mirë të qytetarëve, që me na sjell në kuvend për miratim?

Kryesuesja: Kodi i etikës është duke u zbatuar nga kuvendi dhe po monitorohet nga komisioni i kuvendit, për zyrtarët e komunës është e obliguar të përcillet zbatimimi nga zyra e personelit. Komitetet konsultative janë duke e mbajtur mbledhjet ashtu si e parasheh UA, i kanë nxjerr disa rekomandime dhe i kanë dërgua direkt nëpër drejtori që ndërliidhen komitetet për zbatim, fjalën ja kaloj:

Ali Lutfiu-PDK: I nderuar drejtor i kulturës z Alban Berisha, gjatë festave të Nëntorit ansambli Drenica na përfaqësoi aq bukur ku u shpërblyen më çmimin e dytë. Ansambli Drenica na përfaqësoi edhe jashtë kufijve të Shtetit ku ka marrë edhe çmime të ndryshme. A ka mundësi që të kenë përkrahje më të madhe për nga ana financiare. Duke e ditur vlerën e këtij ansambli presë që të përkrahën më tepër?

Kryesuesja: Me qenë se drejtori nuk është në mbledhje këtë pyetje ja përcjelli dhe një përgjigje ta kthenë përmes emali, fjalën ja kaloj:

Abdulla Gashi-IDEAL: Pyetje për DSHMS znj. Rrezarta Ibrahim, Pyetje për punën dhe funksionimin e QKMF 1.A mundeni me na tregu diçka rreth funksionimit të repartit të gjinekologjisë në QKMF? 2.Çka ndodhi me punësimin e profesionistëve shëndetësorë në QKMF? 3.A mundeni me sqarua çështjen e servisimit dhe mirëmbajtjeve të pajisjeve diagnostikuese në QKMF?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtoresha e DSHMS-së, Rrezarta Hasani-Ibrahimi: Raporti i gjinekologjisë nuk është duke funksionuar për shkak të mungesës së gjinekologëve. Sa i përket profesionistëve shëndetësor, kujdesi shëndetësor ofrohet nga profesionistët shëndetësor si mjekët dhe bashkëpunëtorët të mjekëve. Gjatë vitit 2023 ne i kemi punësuar 19 profesionist shëndetësor prej tyre 14 mjekë të përgjithshëm, 1 mjek stomatologë, dhe jemi në procese për hapjen e konkursit për mjekë dhe infermierë të ri. Sa i përket mirëmbajtjeve dhe servisimit të pajisjeve diagnostikuese në QKMF, e kemi lidhë kontratën dhe kostoja e saj është 110mijë euro.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Mentor Mehmeti-PDK: Pyetje Për: Drejtorinë Komunale të Arsimit, Rezultatet e testit PISA janë mjaft shqetësuese për ne si shoqëri. Renditja në vendet e fundit është një ogur i keq për të ardhmen tonë si shoqëri. A janë mbajtur testet PISA edhe në komunën tonë, nëse po, në cilat shkolla? A keni marrë si Drejtori Komunale rezultatet për komunën tonë, apo ato rezultate janë të përgjithshme për gjithë Republikën e Kosovës? Cilat do të jenë planet tuaja për ngritjen e cilësisë në arsim, gjithmonë në atë çfarë janë brenda kompetencave tuaja si Drejtori Komunale e Arsimit?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Mentor testi pisa është mbajtur gjatë këtij viti dhe grup moshat e nxënësve kanë qenë 15 vjeçare, nga ministria kërkohet për komunën që ti dërgojmë gjithë nxënësit të cilët e kanë arritur atë moshë, pastaj ata e bëjnë përzgjedhjen vetë. Rezultate nuk ka në nivel komunal, po rezultati është në nivele qendrore në nivel shteti.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Kushtrim Dragaj-PDK: Drejtor i kam dy kërkesa prej banorëve të Runikut, kanalizimi të lagja e Xhamisë është bllokua, dhe ndriçimi publik në Runik, ka nevojë me i sanua disa defekte?

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala: Për ndriçimin publik në Runik, javën e parë të janarit kemi me i sajua ato defekte, ndërsa sa i përket kanalizimit sipas mundësive ka me trajtua.

Kryesuesja; Faleminderit, Dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi




Kryesuesja e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbali i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 31.01.2024, ora 10:00.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Punës së Ekzekutivit për vitin 2023, me Nr.02-052/01-0004272/24, të datës 22.01.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
4. Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
5. Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik **Mujë Hoti**, me Nr.02-463/01-0003326/24, të datës 16.01.2024, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
6. Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022, me Nr.03-052/01-0003794/24, të datës 18.01.2024, (Raporton Kordinator SMPK: **Mirsad Gashi**);

Pikat shitesë për këtë rend dite:

7. Propozim-vendimi behet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021, për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve të DSHMS-së, për fëmijët e porsalindur nga shuma 100€, është rritur në vlerë prej 200€, me Nr. Nr.02-400/01-0004958/24, i datës 26.01.2024, (Raporton Drejtori i DBF-së, **z. Ismet Aliu**);
8. Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar të kuvendit, i nderuar nënkryetari i komunës **z. Sami Lushtaku** drejtor të drejtorive, shoqëri civile dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit në sallë janë 27 anëtar, mungon me arsye **Selim Tahir, Osman Smajli, dhe Dardan Shala**.

Para miratimit të rendit të ditës e kemi një pikë shitesë;

-Propozim-vendimi behet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021, për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve të DSHMS-së, për fëmijët e porsalindur nga shuma 100€, është rritur në vlerë prej 200€, me Nr. Nr.02-400/01-0004958/24, i datës 26.01.2024.

-Shkojmë në votim për futjen në rend dite, te kësaj pike:

Konstatojmë me (19) vota për, (2) kundër dhe (3) abstenim, futet si pikë shitesë në rend dite Propozim-vendimi behet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021, për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve të DSHMS-së, për fëmijët e porsalindur nga shuma 100€, është rritur në vlerë prej 200€, me Nr. Nr.02-400/01-0004958/24, i datës 26.01.2024.

Shkojmë me miratimin e rendit ditës, e hap debatin, fjalën ja kalojë:

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, edhe ne si Listë e Pavarur Bekim Jashari IDEAL, e kemi një pikë shtesë për këtë seancë “Propozim për zëvendësimin e anëtares në KPF, për anëtaresen e dorëhequr që ka munguar, dhe të zëvendësojmë me anëtaresen që e propozojmë në si Listë e pavarur, ju ftojë kryesuese që të qiteni në votim, këtë propozim?”

Hysni Mehani-LVV: Fjala përshëndetëse, kur jemi të KPF-ja, kryesuese, tash e keni një vendim shumë të qartë dhe me të prerë të MAPL-së, të cilën e zbaton ose së zbaton, dhe është në kompetencën tende së qysh e trajton tutje rastin.

Kryesuesja; Faleminderit, dikush tjetër, nëse nuk ka, Naser sa i përket anëtares së KPF-së, znj. Fatbardha Haliti-Mustafa e ka dorëzua kërkesën për dorëheqje, ne e kana iniciua procedurën për KKZ, bash me procedurën e zëvendësimit të komitetit jemi tu e prite një përgjigje prej KQZ-së, dhe prej momentit kur te vjen përgjigja prej KQZ-së, me zëvendësimin e anëtares së re, edhe në komitetit do të jenë në një pikë të përbashkët, dhe propozimin e jepni ju si listë. Hysni, unë e kam marr një përgjigje prej MAPL-së, po unë ju kam dërguar prapë shkresë, dhe unë kam marr përgjigje veç për shkresa tuaj, dhe në shkresat të mia nuk kam marr përgjigje dhe kam kërkuar përgjigje të fundit të shkresës sime, dhe në momentin që të marr përgjigje unë ka me procedua edhe atë çështje në kuvend.

-Shkojmë në votim për propozimin e Naser Bajraktarit që të futet si pikë shtesë “Propozim për zëvendësimin e anëtares znj. Fatbardha Haliti-Mustafa në KPF-së, konstatohet me (9) vota për, (15) kundër dhe (1) abstenim, propozimi i Naser Bajraktarit, nuk kalon:

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, konstatohet me (16) vota për, (5) kundër dhe (1) abstenim, Miratohet Rendi i Ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës:

-Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Punës së Ekzekutivit për vitin 2023, me Nr.02-052/01-0004272/24, të datës 22.01.2024, (Raporton drejtori i DBF-së, z. Ismet Aliu, për arsye së Kryetari i Komunës z. Fadil Nura gjendet jashtë vendi);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, para jush e keni Raportit Vjetor të Punës së Ekzekutivit për vitin 2023, një raport që shpalos së çka u punua gjatë një viti për të gjitha drejtorit, kush ka pyetje janë këtu drejtores për përgjigje, raportin e keni para veti, ju ftojë me përkrah.

Kryesuesja; Faleminderit, e hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Faleminderit kryesuese, unë se pari ju falënderojë për zemërsisht të gjitha grupet parlamentare që janë në kuvend, që janë interesuar për shëndetin tim e veçmas Dr. Amir Sejdiun, i cili ka dhënë një kontribut të madhe në intervenimin e shpejte dhe në operimin e suksesshëm që e kisha, andaj edhe një ju falënderohem shume për profesionalizmin e treguar.

Të nderuar koleg nga ekzekutivi kam lexuar këtë raport që na e keni ofruar sot në diskutim, me këtë raporte ma shume kemi te bëjmë raporte i përmbledhjeve të punëve ditore që kryhen nga zyrtaret e juaj, që i kane te parapara si pune te përditshme, sesa kemi para veti raporte te projekteve konkrete te realizuara, apo parashihen ne realizim, apo duke u realizuar. Ne këtë raport jam ndale ne disa pika ku edhe kërkojë informata nga drejtores te cilët i përfaqësojnë drejtoritë. Asgjë nuk kemi personale përpos që kemi nevojë te diskutojmë, te japim vërejtje, sugjerimet kritika, por edhe ndonjë opsione që është me i favorshëm që i vlen ekzekutivit. 1.Për Drejtorin e Administratës z. Hamit Geci ti në raport e thua këtu ku është te raporti tek qendra për shërbimin e qytetarëve/arkiva. Është hartuar lista e shenjave te klasifikimit te dokumenteve me afatet e ruajtjes, ku është dhënë pëlqimi nga Agjensioni shtetëror i arkivave te Kosovës dhe nga arkivi nderkomunal i Mitrovicës. Pyetja ime është pe ty drejtor çfarë pëlqimi ju kane dhënë këto dy institucione për këto dy dokumente, a bene te na njoftoni konkretisht. 2. Tek Drejtoria tek raporti I drejtorit te prokurimit tek tabela kontratat e nënshkruara publike për vitin fiskal 2023 thuhet tek kodi asfaltimi i rrugës

Rakinic-Çubrel ri-tenderim, pune shtese kontrata e nënshkruar, Mesa di unë ase qe u nise ajo rruge tek raporti qe ofron drejtoria për Urbanizëm ne realizim te projekteve për vitin 2023 fare nuk figuron kjo rruge e realizuar, e çka është edhe ma interesante qe nuk figuron ase ne bartje për vitin 2024, qe jepe me kuptua qe kjo rruge sikurse edhe shume projekte tjera do te lihen ne agjendën e për projekte gjate fushatës elektorale zgjedhore qe do te mbahen 2025. Ne raport kemi ne realizim ne bartje nga 2023 ne vitin 2024 ndërtimin e rrugës Kotorr-Qubrel, kjo rruge është ne projektet e realizuara edhe ne vitin 2022, tash po e shoh te bartura për vitin 2024, drejtor a ka mundësi te na ofroni sqarime konkrete. A kane përfundua apo kure priten te përfundojnë, apo do ta kenë fatin si shume projekte tjera qe kane dështuar apo do ta kenë fatin e pritjes sikurse rruge Dashefc-Polac, Rakinic-Qubrel, si dhe fatin e pritjes se zgjidhjes se problemit te kanalizimit ne fshatin Polac i bartur ne realizim qe nga viti 2013/14, e fatin e pritjes po e beje edhe unë personalisht ne këtë projekt. Tek Drejtoria e Bujqësisë, Drejtor raporti i juaj është mjaftë i ceket, apo mund te them lirishite jo Profesional, duke e pasur parasysh se është njeri nder drejtoritë qe është deshtë te na ofroni raport me te të gjere me te dhëna ma te qarta, ku nuk kemi njohuri me këtë raport cilat sektorë si drejtoret i ke përkrah. Asgjë ne raporte nuk kemi për korrije shirjet, sa hektar i kemi te mbjella me grurë, sa ka qene rendimenti i grurit ne (ha), njëjte vlen edhe për kultura tjera. Drejtor edhe me pare te kemi rekomanduar ne kuvend, bolle me projekte emergjente, sepse ka shkuar koha e tyre sepse kemi thënë qe ne këtë forme nuk zhvillohet bujqësia dhe nuk ndihmohet fermeri i vërtete. Kemi rekomanduar serra 5 ari, e jo serra 1 ari apo gjysme ari te cilat qe dobët punohen saqë po fluturojnë mbi kulme te shtëpive. S’kemi asnjë sqarim ne raport për organizimin për këshillim me fermer ne asnjë sektor, me sa Kam pare ase ne teren pore ase ne faqen e publikimeve ne faqen e komunës te cilën e përcjelli rregullisht. Ne raport keni theksuar 42 përfitues (25 hektar plantacione, na njofto të lutem konkretisht çka janë të mbjellura dhe ku gjenden ato plantacione, se kogja hapësirë e madhe 25 ha. Kjo praktik e juaja ju ofron ndihme njerëzve pa punëtorë qe qellim te vetin e kane vetëm përfitimin dhe stërshitjen si shembull 40 Copa pula dhe projekte tjera. Na ofro dëshmi sa ju kanë shite frezat, moto kultivatorët, plugjet e pajisje tjera te shpërndara, a i keni monitoruar hiqe apo qëllimi ka qene t’ju ofroni këto ndihma militantëve partiak, dhe ju përsëri përkundër kësaj ju vazhdoni përsëri me te njëjtin avaz me thirrjen e fundit qe e keni publikuar. Drejtor me këtë qasje nuk ndihmohet bujqësia dhe fermerët e vërtetë dhe nuk do te kemi bujqësi ne regjenerimin e vendeve te punës. Tek Drejtoria e Inspektoratit drejtor Valon Haliti, Drejtor a keni marre ndonjë mase ne inspektim dhe a keni bere ndonjë kallëzim ne globe, apo penal ndaj shkaktarëve dhe keqbërësve në dëmtimin e hapësirave publike duke gjuajtur mbeturina dhe materialë inerte vend e pa vend. Faleminderit te nderuar besojte qe do te me keni kuptuar drejte ne diskutimin time.

Hysni Mehani-LVV: Tash Afrimi po i drejtohet drejtorit, po kur mungon kryetari, e prezent është nënkryetari duhet me ju drejtua nënkryetarit, po unë besojë që edhe raportin duhet me prezantua nënkryetari, së nënkryetari aktual i komunës është personi që e mban barrën për këtë qeverisje, rrjedhimisht nuk duhet me u m’shefe prapa drejtorit. Ajo çka po dua tash me i ngrit disa çështje, fillimisht në debat kur flasim nuk flasim për planin e punës në kuptimin e asaj të obligimeve ditore, po ky plan i punës do duhej me reflektua premtimet elektorale që janë dhënë në fushatë, dhe prej të parëve që do të duhet me marr fjalën do duhej të ishte dikush prej këshilltarëve të PDK-së, të cilët dalin e tregojnë sa është realizuar premtimi i tyre elektorale, po dalin e flasin këtu me një farë krenarie të madhe. Nëse e shohim realizimin e projekteve dalin që janë 8 projekte të realizuara, unë kam qenë kritik në qeverisjen e Bekim Jashari, konkretisht për 2-3 individ brenda asaj qeverisje, po krejt çka po bëni ju, fatkeqësisht që po preni shirita të projekteve të Bekim Jasharit, që s’po ka kush i mbron, me dal e me ju thanë kadalë së nuk janë këto projekte të juaj. Edhe është

pak shqetësuese kur e sheh, zhvillim socio ekonomik i mirëqenies së qytetarëve konsiderohet, me ja hap një pus me pi ujë, ky nuk është zhvillim socio ekonomik, po ky është kushti minimal i jetesës. Për me pas të qartë këtë raport po i parashtroj disa pyetje: 1. Cilat janë prioritetet që i kanë ndryshuar vërshimet? 2. Sa vendime janë kthyer të jashtëligjshme nga MAPL-ja? 3. Të drejtoria e administratës, sa veta e kanë ndërrua vendbanimin që e kanë marr certifikatën për me ndërrua vendbanimin? 4. Të prokurimi thuhet së është nënshkruar kontrata për tribunat të stadiumit dhe për shtatore të UÇK-së, pjesë e sajë është edhe z. Lushtaku dhe ndërkohë që ky projekt është shty për vitin 2025, as nuk ka fillua, po në prokurim thuhet së është iniciua procedura? 5. Në drejtorin e Arsimit thuhet së shkollat janë pajisur me llap top dhe e me destop, sa shkolla janë pajisur dhe cilat shkolla janë pajisur? 6. Për transparencë që jeni radhitur në vendin e parë sipas KDI-së, po ka do raporte tjera që jeni radhitur në vendin e 10, dhe kur thua që jeni radhitë nga KDI-ja në vendin e parë, thoni në raport që jemi edhe diku tjetër në vendin e 10.

Kryesuesja: Faleminderit, fjalën ja kaloj:

Nënkryetarit të Komunës, Sami Lushtaku: Fjala përshëndetëse, unë t' jam i singerte e kam lexuar materialin, dhe e raportoj drejtori këtë pjesë, po desha me z. Mehani, mua me vjen mirë për së cilën kritik që e banë po edhe të tjerët që e bëjnë këtu, po unë presë edhe prej deputeteve të PDK-së që kanë vend për kritika dhe për vërejtje na i mirëpresim po ato vërejtje ato kritika të janë të arsyeshme. PDK-ja ka fitua në Skenderaj dhe po besoj që PDK-ja po i kryen obligimet që i ka marrë para qytetarit të vetë, më këto mundësi që i kemi, dhe unë po besoj që ne kemi punuar me shume së qeveria e Kosovës, së paku ne po presim shirita me këto mjete që i kemi dhe ndoshta e ke përcjell së cila është ndihma e qeveris në raport me komunën e Skenderajt. Ne kemi mundësi me u shty politikisht po në momentin që fiton dikush, e në këtë rast PDK-ja ka fitua këtu, duhet me punua, po me mundësit që i ka, jo jashtë mundësive. Nëse PDK-ja, kryetari, dhe drejtoret punojnë apo punën e bëjnë keq, hajde flasim, jemi të gatshëm me u përgjigj këtu, po ti fol gjithë me tendencë, ti fol pa arsye, unë kërkoj prej teje dhe të tjerëve që kritikën mos ti ndalni veç të jeni të arsyeshëm në vërejtje dhe kritika, po ti e bënë për inate këtë punë, e kuptoj pozicionin tënd dhe të anëtarëve tjerë që dolën nga salla, unë nuk e di cila është mundësia, së nëse kërkesa e opozitës është e arsyeshme unë jam që me i kalua ato kërkesa, dhe nuk kam inate politike këtu me askënd, as personale, prandaj uroj që kritikën, vërejtjet të janë të arsyeshme dhe i presë me kënaqësi të madhe.

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Komuna jonë gjatë vite 2023 u ballafaqua me vërshime e cila e përfshiu një pjesë të territorit të komunës së Skenderajt, dhe ne kishim nevojë për trajtim të lumit të cilin e ka shkaktuar këtë fatkeqësi, dhe prioritetet tona ndryshuan në aspektin financiar, sidomos në futjen e pastrimit dhe zgjerimin e këtyre lumenjve dhe kishim ngadalësim në procedurat e realizmit të projekteve të tjera dhe nuk kishim mjete të mjaftueshëm për trajtimin e këtyre lumenjve. Ne gjatë viti 2023 realizuam një buxhet nga të hyrat vetanake i cili ishte tejkaluar mbi 44% në realizim të te hyrave vetanake dhe këto të hyra i kemi dedikuar për këto projekte, diçka tjetër nuk nga aspekti financiar.

Drejtori i DA, Hamit Geci: Fjala përshëndetës, është komuna e parë që e kemi miratuar këtë listë, dhe kjo listë është si model për komunat tjera, dhe këtu bëhet klasifikimi i dokumenteve, dhe së cili dokument e ka afatin e ruajtjes. Dhe është dokumenti tjetër që na është dhënë pëlqimi nga Arkiva Nderkomunalë e Mitrovicës dhe i klasifikon dokumentet të cilët janë pa vlerë si juridike, historike dhe hulumtuese që i kemi ne në objektin e komunës në arkiv dhe të asgjësohet, dhe është formuar edhe një komision që më bë asgjësimin e këtij dokumentacioni. Hysni i kemi diku 25 ndërrim të vendbanimeve, që i kanë nxjerre dokumentet.

Drejtori i DBPZHR-së, Behxhet Maliqi: Fjala përshëndetëse, Afrim kam mundur me raportua me shume për së cilin punëtor çka bënë, po ajo është punë rutinë që e bëjnë çdo ditë punëtori. Ne kemi një program politik të cilin kemi ardhur me zbatua, dhe jemi tu e zbatua, dhe në bazë të atij programi politik i kemi fitua zgjedhjet. Unë e di që vullneti i jote politik u kanë ndryshe po qytetari ka vendosur që ne me qeveris, për derisa qytetari ka vendosur, ne kemi me i zbatua edhe me i implementua ato premtime që ja këna dhënë qytetarit. Në bazë të premtimeve ne si drejtori jemi tu e bë maksimumin, ndoshta e dinë sa përfitues janë kanë vitin e kaluar, dua me falënderua ekipin e drejtorisë së bujqësisë që e ka bë një punë të jashtëzakonshëm që u kanë bë dikun 12 mijë shërbime për qytetarë gjatë vitit 2023, nuk ka ndodhur as një rrahje qysh ka ndodhur herëve të kaluara, dhe kemi punuar deri 5-6 dhe qëllimi u kanë që qytetari me i krye shërbim. Më këtë buxhet që e kemi nuk mundem me zhvillua bujqësinë, e jona është me zbatua programin politik në bazë të te cilave i kemi fituar zgjedhjet. Sa i përket raporteve pa dashur metë ofendua as mete shty, ta mbajë një kurs të tregoj qysh bëhet raporti, ndoshta nuk jam agronom i mirë si ti, po sa i përket raportit i kam 21 vite shkollë. E përmende shitjen e pajisjeve që i kemi shpërnda, ne e kemi një marrëveshje me çdo fermerët që kanë marr pajisje, dhe çdo fermer që e ka marr pajisjen 3 vite ka drejtë me punua me atë pajisje, çdo vite bëjmë monitorime, po nuk bëjmë monitorim 100% sepse është e pamundur, po çdo kush që gjendet që e ka shit pajisjen ka mu përgjigj në bazë të marrëveshjes që e ka nënshkrua, dhe çdo informatë që ka dikush na informoni përmes arkivit dhe ne kemi me shkua me kontrollua, mos u merrni me fjalë të kafeve, leni zyrtaret ti kryen punët e veta.

Drejtoresha e DZHENIT-së, Besarta Meha-Ademi: Fjala përshëndetëse, me qenë së mu cek një prej programeve të grandeve të cilët ne i bëjmë si drejtori, po i cek unë disa prej grandeve kryesore që ne i mbajmë me bankën botërore dhe bashkimin evropian janë 120 mijë euro që janë nda gjatë vitit të kaluar për moshat 18 deri 24 vjet për përfshirjen në komitete, afër 100 mijë euro për shoqëri civile të cilat janë ndarë me UNDP-në, dhe janë si fonde të bashkimit Evropian dhe është shume me e madhe e ndarë ndonjëherë për shoqërinë civile në Skenderaj. Janë 30 biznese që janë mbështetur me grandë nga ne si komunë dhe nga UNDP-ja, pastaj është edhe programi i praktikës në punë me pagës për të rinjtë e diplomuar deri në moshën 24 vjet, që ka për qëllim kryesor përgatitjen për treg të punës.

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Fjala përshëndetëse, Hysni furnizimi është bë në bazë të kërkesave të shkollave, këto shkolla janë furnizua tërësisht : Shaban Jashari, Ahmet Delija, Shote Galica, Abedin Regja, Elena Gjika, Vëllezrit Frashëri, Drenica, dhe janë 5 shkolla që janë furnizua pjesërisht.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Afrim sa i përket rrugës Rakinic-Qubrel, ka qenë në projekt janë kanë të parapara 50mijë€, kontrata është paguar 90mijë€, dhe është bë një aneks kontratë rreth 9100€, dhe nuk është zhvillua projekti, po është zhvillua projekti i rrugës ka Ali Obrit, është bë një sanim i rrugës kryesore, janë shtruar disa rrugë në lagjen Durmishi, sa i përket rrugës Kotorr-Qubrel, ka qenë një projekt i viteve paraprake, është ndërpre kontrata për shkak të inflacionit, dhe tash e ka fitua një kompani tjetër. Sa i përket kanalizimit në fshatin Polac këna punua vitin e kaluar shume, një pjesë ka Veliqt ka pas telashe si të përfundojnë ato telashe i kryem, se e kemi në kodë buxhetor edhe 130mijë€.

Drejtori i DI-së, Valon Haliti: Fjala përshëndetëse, si drejtori e inspektoratit ne kemi marr masa ndaj ndotësve ilegal që hedhin mbeturina inerte vend e pa vend, pasi që në këtë asamble me vendim është caktuar deponia për mbeturina inerte në fsh.Qirezë, po për kundër kësaj një numër i madh i qytetarëve të pa përgjegjshëm kanë vazhduar me hedhe mbeturina vend e pa vend, e kemi

vështirosua pak situatën për arsye së DSHP-së ka vendosur kamera në shumicën e qytetit dhe kemi me pas me letë me veprua për identifikimin e atyre personave.

Kryesuesja: Replikë 1 min.

Hysni Mehani-LVV: Tash z. Lushtaku me quajti tendencioz, së qysh komunikon me publikun e njohim, po vetëm këto që i përmendi a i konsideron tendencioze të punës së juaj si: Niveli i realizimit të planit komunal për menaxhimin e fatkeqësive 0.00%, Vendbanimet e përfshira në sistemin për trajtimin e ujërave të zeza 12.24%, Vend parkime për mjetet motorike në territorin e komunës 22.38%, Realizimi i planit komunal për transport lokal publik 0.00%, Barazia gjinore tek emërtimet e rrugëve 5.86%, Plani komunal për barazi gjinore 0.00%, Barazia gjinore tek përbërja e këshillave lokale 0.00%, Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis 0.00%, Plotësimi i buxhetit për arsim prej të hyrave vetanake 0.50%, Plani për zhvillim ekonomik lokal 0.00%, Të punësuar me nevoja të veçanta në institucione 31.5%, Gjatësia e rrugëve lokale të pajisur me ndriçim publik 16.16%, Gjatësia e rrugëve lokale të pajisur me trotuar 13.84%, Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së dimrit 46.50%, Rrugët lokale të mirëmbajtura gjatë sezonës së verës 9.72%, dhe përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komuna prej të hyrave vetanake 2.93%. Pra a janë këto tendencioze, nëse janë këto tendencioze atëherë këto janë të planit të punës që e kanë përgatitë njerëzit tu, jo unë, dhe çështja tjetër shumë i qetë dhe shumë konkret as një tendencë, nisu prej tri projekteve që i ke realizua edhe planë program është që me ja dhënë djalit të vëllait 400 mijë euro për sigurim.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Nënkryetarit të komunës, Sami Lushtaku: Për që je tendencioz unë e di që je, po s'ka rëndësi roli i jot është, je në një subjekt tjetër politik ti këtu je veç me kritikua dhe unë thash që kritiko veç të jesh racional. Partia Demokratike në Skenderaj i ka përmbushur premtimet që i ka dhënë në fushat, vazhdon me punua dhe me u angazhua maksimalisht me këto mundësit që i kemi. E di që ti nuk je i kënaqur po ti nuk je i kënaqur që ka fitua PDK, ti është mirë me shkua të kryeministri të aj sharllatani me kërkua ndihmë me i ndihmua komunës tanë që edhe ti je i Skenderajt. E drejta e së cilit qytetar është këtu me konkurrue për projektet, po edhe djali i vëllait tim, nëse aj s'ka drejt thuaj, nëse aj e ka shkel ligjin, shko në prokurori, se je mësua me nejt në prokurori, dhe që të vyen ndonjë kerr ta paguajmë me shkua. Dhe krejt këto projekte i ka bë PDK-ja nuk i ka bë dikush tjetër, po ti vazhdo me kritikua të vërteten jo të pa vërteten.

Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci: Fjala përshëndetëse, desha mu ndërlihdh me pyetjen që e bëri z. Mehani që komuna jonë po radhitet në venin e 10 për performancë, a mundsh me na potencua në cilin raport po radhitem në vendin e 10, jemi nder komuna e parë në raportin e KDI-së, dhe nuk e di në cilin raport po radhitem në vendin e 10, dhe kisha dashtë me qenë pak me i saktë. E pash që për raportin tim nuk the asgjë, po ndoshta të arriturat tona nuk të pëlqejnë sepse kemi pas rritje të buxhetit për 206% dhe këtu nuk po apostrofon fare, së për të mirat e arriturat në komunë duhet me qenë edhe ti i kënaqur se je banorë i kësaj komunë, mos i shiko vetëm anët negative.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Hysni Mehani-LVV: Unë flasë për çështje konkrete gjatë gjithë kohës për letra për dokumente, ju e ktheni personale, pra z. Lushtaku, prapë po të drejtohem mi thuaj 3 projekte që i ke realizua në të mirë të qytetarit nëse i dinë? Dhe asnjëherë nuk e qesë në nivelin e tendencës unë flas në ata qa ka në letër e kjo po thotë së performanca është zero, në shumicën e çështjeve, dhe nuk duhet me ja dhënë dikujt fjalën që e ka me ja nisë me etiketua dhe me denigrua dikën në rrafshin personal, nëse ka probleme letë flet, nëse jeni të kënaqur që ku i keni 17 asamblisti letë dalin letë flasin për këtë raport.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Hysni, projektet janë këta: Fasadimi i sheshit të objekteve, Subqendra Runik e cila është në përfundim, Unaza në lagjen 2, Llaushë, Rruga lagjen 3, Prekaz , Unaza e qytetit pas gjykatës, Parkingu, Poligoni multifunksional, Rrugët Vajnik, Kanalizimin Burojë, Rruga Surigan, Bjeshkët e Suriganes, Rruga Kozhic Qirez.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati për këtë pike, shkojmë në votim konstatojmë me (16) vota për, (2) kundër dhe (1) abstenim përkrah Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Punës së Ekzekutiv it për vitin 2023, me Nr.02-052/01-0004272/24, të datës 22.01.2024,

Vazhdojmë me piken 4 të rendi ditës:

-Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024, (Raporton);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu; Para veti e keni Raportin Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, ky është raport i fundit për vitin 2023, sipas ligjit behën tre raportime për çdo tre muaj, ky raport pasqyroni me saktë të gjitha të dhënat lidhur me buxhetin 2023. Buxheti fillestar e kemi pas të aprovuar 16,299,423.55€, ndërsa ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, deri në buxhet final është 19,058,367.72€, i shpenzuar në 5 kategori ekonomike në: Paga dhe shtesa, Mallra dhe shërbime, Shërbime komunale, Subvencione, dhe Investime kapitale. Përformanc të mirë ka pas të lejet e ndërtimit, gjithashtu edhe e hyrë kryesorë është edhe tatimi në pronë që është tejkaluar me 10%, plani ka qenë 340mijë€, ndërsa të grumbulluar janë 374mijë€, të hyrat tjera s'po i lexoj, materialin e keni para veti, kush ka pyetje për këtë raport jam këtu për çdo përgjigje.

Kryesuesja: Faleminderit, e hapë debatin fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: Faleminderit kryesues, gjate leximit te ketij raporti qe për mua si asamblistë janë te paqarta, andaj kam disa pyetje qe nga drejtori Ismet Aliu kërkoje informata plotësues sipas kodeve: Tek kodi 13140 shpenzime ne udhëtime jashtë vendit kemi një krahasim të madhe ndere vite 2021 (824.00€)ne vitin 2022 (592.00€) ne vitin 2023 (7,133.00€) Drejtor a ka mundësi sqarim për çka është fjala për këtë rritje në shpenzim, kure këtu i shtohet edhe plus shpenzim ne akomodim 2457.00€, mëditje për udhëtim 642.80€, si dhe shpenzime tjera të udhëtimeve thera zyrtare jashtë vendit 2490.19€, kure te gjitha këto shpenzime nuk ishin as ne vitin 2021 dhe as ne vitin 2022. Të kodi 13440 shërbime ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënës shuma e shpenzuar 13282,55€. A mund te na njoftoni konkretisht për çka nënkuptojmë me këto shërbime ne shumen e shpenzuar. Tek kodi 14050 mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve shuma e shpenzuar 62144.73€, drejtor n sqaro për çka behet fjale se kemi një shpenzim enorm po me duket. Tek kodi 14310 dreka zyrtare edhe pse kemi një ulje ne krahasim me vitin 2022, prape se prape kemi një rritje shume te larte ne vitin 2021(1,8780.25€)ne vitin 2022 (3, 7135.15€) ne vitin 2023 (3,4333.81€), A ka mundësi te na njoftoni çka është kjo rritje ne këto darka zyrtare. Tek kodi 15503 komp. me pake se 1000€, shpenzime shume te larta ne krahasim me vitin paraprak, ne vitin 2022 shpenzime 16160.44€, ne vitin 2023(74653.80€). Tek kodi 13509 pajisje tjera me pake se 1000 euro shpenzime 32600.46€. Tek kodi 14032 mirëmbajtja e auto rrugëve lokale shuma e shpenzuar 202184.26€, a ka mundësi te kemi një sqarim nga e juaj për këto shpenzime. Kodi 13610 furnizim ne zyre shuma e shpenzuara 112842.58€, është një rritje shume e larte ne krahasim me vitet paraprake 2021, si dhe 2022. Ne raport keni thënë se subvencionet kane shënuar rritje prej 75.23% qe i bie sipas raportit te dhënë nga Ana e juaj ne tabelë 1.407504 €, kurse pjesëmarrja ne shpenzime e buxhetit 7.52%. Drejtor a ka mundësi te kemi një informacion te plote ku është subvencionuar kjo shume aq e larte në cilët sektor, sepse kemi shifër ne numra, pore nuk kemi raporte ku është subvencionuar. Faleminderit për mirëkuptim!

Hysni Mehani-LVV: Për me pa raportin unë e kam marr raportin e miratuar në vitin 2022, për më bë një krahasim më atë së çka këna miratuar e çka na është sjell në raport, edhe këtu vërehet një dallim i madh në lidhje me buxhetin sa që shkon deri në 640mijë€, pra rregullimi i subqendrës në Qirezë është 180mijë €, në këtu është zero, fshihet prej raportimit fare, është veç të te hyrat vetanake ndryshojnë shifrat, po ashtu edhe subqendra në Likoc ndryshon shifra, të shkronja U e UÇK-së, i kemi miratua 500mijë €, janë veç 420mijë €, të raportuara, edhe të shpenzuara e bënë 100%, pra prej asaj që i ke raportuara i ke mangi 80mijë€, pra e ke zbrit shifrën e ke bë realizimin 100%, ashtu edhe të shtatorja e UÇK-së, kanalizimi Klin-Kuqic, e projektet tjera që vlera shkon diku 640mijë€, të devijuara në raport. Po ashtu deklaroj së i kemi të pa shpenzuar për investime kapitale 83,761.00€, që ndërkohë që vetë deklaroni për investime kapitale i keni 4,969,096.17€, që diferenca është 217mijë€ të pashfrytëzuara. Ndërkohë për bartje i kemi 308,774.85€, e po ashtu deklaroni që i kemi 480mijë€, me shume nga të hyrat vetanake, prej të cilave si pasojë që nuk i keni planifikuar mirë nuk keni mundur edhe me i shfrytëzua. Thatë së po qeverisni mirë po dalin diku mbi 1.600.000.00€, të ndara në pjesë pjesë, ose të devijuara në raportim ose të keq shpenzuara, pra e keni në buxhet e nuk po e merr barrën aty dikun 5 milion për investime kapitale e diferencën e keni 1.600.000.00€, kaq mirë që qeverisni, të pështjelluara në gjepa dhe skuta që unë nuk jam prokurorë për me ditë së ku janë po ka një farë pështjellimi këtu. Drejtor me ushtruesin e detyrës së kryetarit keni deklarua publikisht në vitin 2023, së kemi ble vetura të reja, për arsye së kostoja e mirëmbajtjes së veturave është shumë me e lartë, ku Skenderaj ka pas vërshime dhe thojshi krejt qytetet tjera janë solidarizua me gjendjen në Skenderaj. E çka keni bë ju keni ble vetura 160mijë€, edhe pse janë kanë të planifikuar 80mijë€, në ndërkohe e keni rritë edhe koston e mirëmbajtjes së veturave prej 29mijë€ në 2021, në 62,817.12€ në vitin 2023, pra edhe vetura të reja edhe trefishim i mirëmbajtjes së veturave aktuale. Pra gjitha kategoritë pësojnë ngritje si: Furnizimi për zyre prej 53,040.58€, në 112,842.58€, Dru prej 123,325.60€, në 228,669.61€, pra të gjitha kategoritë kanë pësua rritje përveç Furnizimi me ushqim, veshmbathje, furnizime mjekësor, pra nëse kemi pas vërshime e buxheti ka devijua për shkak të vërshimeve, kategoritë që do të duhej me pas ndryshime rritje, po këto përkundrazi kanë pas ulje. Ky raport e ka edhe një risi të re, prej që jam anëtarë i kuvendit nuk e kam hasur që darkat janë shkua në 34mijë€, po edhe mëshefen së sa ka shpenzuar zyra e kryetarit për dreka e darka.

Kryesuesja: Faleminderit, fjalën ja kaloj:

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Sa i përket të dhënave statistikore ky raport është 100% i saktë, dhe transparent, barazimet mujore çdo herë i bëjmë me MF, dhe nga ky kuvend ky raport dërgohet në MF, çdo gjë që ka ndodhur me parinë publike gjatë vitit 2023 është e prezantuar këtu saktë pa asnjë devijim që i përmende ti ato shifra. Sa i përket shpenzimeve të zyra e kryetarit, unë e kam hartuar këtë raport neper kategori ekonomike, në raportet tre mujore çdo here e kam sjell edhe raportimin sipas drejtorive që së kam pas obligative, që për me ditë çdo drejtori shpenzimet e veta saktë, po janë të përmbledhura në mallra dhe shërbime gjitha këto shpenzime. Është shpenzuar me shume në vitin 2023, po edhe buxheti ka qenë me i madh për vitin 2023, në të gjitha kategoritë në veçanti në mallra dhe shërbime, duhet me marr parasysh çmimet me të larta, inflacioni, kriza ekonomike dhe këto kanë ndikuar me një shpenzim me të madh të kategorive. Të shpenzimet që i përmendi Afrimi: Te kodi 13140 shpenzime ne udhëtime jashtë vendit, ky shpenzim është që kanë qenë dy delegacione jashtë vendi, njeri në Vokuvar dhe në SHBA. Të kodi 13440 shërbime ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënës, ky shpenzim është të shoqëria civile e cila merr pjesë në konkurset që zhvillohen në komunë. Tek kodi 14050 mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve. Tek kodi 15503 komp. me pake se 1000€, janë shpenzime që kanë ndodhur për furnizime me kompjuter, për zyrtaret e komunës. Sa i përket subvencionimit kemi pas rritje të përqindjes për

arsye së në këtë kategori janë hy edhe donacionet që janë sjelle nga qytetaret për vërshime dhe për këtë ka pas rritje në këtë kategori. U përmenden 480mijë€, të hyra vetanake, ne e kemi pas një planë për me i realizua të hyrat vetanake për vitin 2023 është tejkaluar e këna bë një riplanifikim në shtator, 480mijë€, për fate të mirë ka rezultuar edhe me mirë që keni tejkalim diku 180mijë€, që duhet të përsëritet me vendim të kuvendit. Thatë që ka diferencë të pa shpenzuar që 308,774.85€, do të mbesin të hyra të pa shpenzuara për vitin 2023, janë edhe do gjoha të gjykatës me e kompletua si raport diku 350mijë€, do të mbesin për bartje. Të hyrat vetanake nuk shkojnë në suficite i bartim i shpenzime në vitin 2024, dhe 83,761.98€ kanë mbete për projekte kapitale. Të veturat është e vërtetë së kostoja e mirëmbajtjes ka qenë e lartë në krahasim më vitin 2022, për arsye së gjitha veturat janë furnizua me dy parë guma dimër verë, si veturat e komunës të zjarrfikëseve, po këto shpenzime nuk kanë me u përsërit viteve në vazhdim.

Kryesuesja: replikë 1 min.

Hysni Mehani-LVV: Drejtor ky është raporti që e këna miratuar buxhetin 2023, ta japi nëse donë raportin me lexua e bëre krahasimin, dhe a bënë mem tregua ku i ke këto 180mijë€, dhe 500mijë€, në këtë raporte që na ke pru, unë sene s'po thamë veç po e bëjë një krahasim më këtë që na ke pru ti, këto janë fakte.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Armir Sejdiu-PDK: Fjala përshëndetëse, desha ta plotësoj drejtorin e financave, edhe një sqarim me ja dhënë Afrimit, që thotë se kemi rritje të shpenzimet neper kategori për vitin 2023, kjo rritje ka ndodh së vitet tjera jemi kanë të mbyllur me pandemi covid-19, dhe nuk u lejoheshin vizitat jashtë vendi, dhe arsyeja e rritjes është e qartë.

Kryesuesja: Me kaq mbyllet debati për këtë pike, shkojmë në votim konstatojmë me (17) vota për, (2) kundër dhe (0) abstenim përkrasht Shqyrtimi i Raportit Përfundimtar të Buxhetit Komunal Janar-Dhjetor 2023, me Nr.02-052/01-0004333/24, të datës 23.01.2024.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës:

-Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, Nr.02-463/01-0003326/24, datë 16.01.2024, (Raporton), **Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Propozim vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti, procedurë e iniciuar me kërkesë të personit fizik Mujë Hoti, e cila në vazhdimësi nga viti 2021 ka bërë kërkesë për kompensimin e pronës që ju ka marrë për realizimin e projektit për zgjerimin e rrugës Morinë-Rezallë, prona e cila propozohet të këmbehet janë ngatrrat nr.595-0, me sip. 1109m², nga sipërfaqja e përgjithshëm 23503m², dhe ngastra Nr.600-0, me sipërfaqe 767m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7596m², që ne total për këmbim propozohet sipërfaqja 1876m². Më pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti ngastra Nr.208-0me sipërfaqe 1876m² nga sipërfaqja e përgjithshëm 8055m², ju ftoj me përkrasht.

Kryesuesja: Faleminderit kryetar, e hape debatin nëse nuk ka konstatojmë me (17) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Skenderajt, me pronën e paluajtshme të personit fizik Mujë Hoti.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës:

-Shqyrtimi i Raportit të përfundimit të Komunitetit të Komunës së Skenderajt për vitin 2022, me Nr.03-052/01-0003794/24, të datës 18.01.2024, (Raporton);

Koordinatori Komunal i Përfundimit të Mirsad Gashi; E nderuar Kryesuese, i nderuar nënkryetar, te nderuar asamblistë dhe drejtorë. Jam sot para jush ne cilësinë e koordinatorit të SMPK-se, për te paraqitur për diskutim Reportin e Vlerësimit të Performances së komunës nga Mapl-ja. Komuna e Skenderajt konform legjislacionit ka emëruar komisioni komunal për

performance, i cili ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Raportimi për vitin 2022 ka filluar me date 07.08.2023 dhe ka zgjatur deri me 25.09.2023. Ky proces mundësohet nga Mapl, Demos dhe Donatorët e Grantit. Për vitin 2022 Skenderaj ka dalur mbi mesataren e komunave gjë që ka ndikuar te kemi një performance relativisht te mire, ndërsa me vlerësimin jemi pajtuar që është real. Ky proces përfshinë 19 fusha ne te cilat Skenderaj ka rezultuar me këto përqindje: Shërbimet administrative 94.82%, Transparenca 98.98%, Përgjegjshmëria 62.61%, Barazia ne punësim shërbimet familjare dhe sociale 72.61%, Kulture Rini e Sport 100%, Menaxhimi i fatkeqësive 50%, Planifikimi hapësinor 100%, Hapësira publike 100%, Infrastruktura rrugore 46.53%, Transport Publik 62.57%, Parkingje publike 71.90, Ujë i pijshëm 75%, Kanalizim 50.66, Menaxhim i mbeturinave 76.27%, Mbrojtja e Mjedisit 62.63%, Barazia gjinore 35.72%, Arsimi parauniversitar 69.65%, Kujdesi primar shëndetësor 72.17%, Zhvillimi ekonomik lokal 61.36%. Por si shqetësim mbeten këshillat e fshatrave, barazia gjinore, plani për ambient, plani per emergjenca, raportimi i auditorit te brendshëm ne kuvend komunal, raportimi për Smpk, rritja e pjesëmarrësve ne diskutime publike, plani për transport, implementimi i rekomandimeve te Zka, mirëmbajtja e rrugëve, raportet e diskutimeve publike, buxhetimi gjinor, rritja e buxhetit për shëndetësi dhe arsim nga te hyrat vetanake dhe tregues te tjerë. Bashkangjitur me materialin keni përpara raportin e Mapl-se për secilin tregues se si është raportuar dhe se si është vlerësuar, nëse keni pyetje urdhëroni.

Kryesuesja: Faleminderit, e hap debatin, fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi: Kam tri pyetje, Mirsad a pritet me fitua diçka nga kjo performance? nëse po ku shkojnë ato mjete? Po ashtu e kam ngritur çështjen e këshillave te fshatrave, pse nuk po formohen, dhe në një seancë të kuvendit, Drenasi e ka përmend çështjen e Skenderajt dhe pse ne mu përmend në Drenas, dhe shikoni dhe jepni një rekomandim.

Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, sa i përket raportit përfundimtar të performances për komunën e Skenderajt, pa dyshim është një raporte i cili mundet me u marr shembull nga të gjitha komunat e Rep. së Kosovës, dhe unë si këshilltare komunale, në këtë kuvend gjatë këtij mandati jam të jetë krenare sa i përket këtij raporti, dhe shpresoj me vazhdua kështu edhe për vitet e ardhshme.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Mirsad Gashi: Mjetet ndahen nga Mapl dhe Donoret, ato do te përdoren në projekte te investimeve kapitale, ndërsa sa për Shumen jemi duke pritur ende raportin final për Grantin e bazuar në performance. Sa i përket këshillave të fshatrave, meqenëse kryetari nuk qenka këtu, po përgjigjem pjesërisht sa për sqarim, kjo çështje është ne kompetence te ekzekutivit dhe legjislativit qe bashkarish me propozua dhe miratua emërimin e komisionit qe do t' i zgjedh apo formoje këshillat e fshatrave.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (17) vota për, (0) kundër dhe (1) abstenim përkrahë Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Skenderajt për vitin 2022, me Nr.03-052/01-0003794/24, të datës 18.01.2024.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit të ditës:

-Propozim-vendimi behet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021, për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve të DSHMS-së, për fëmijët e porsalindur nga shuma 100€, është rritur në vlerë prej 200€, me Nr. Nr.02-400/01-0004958/24, i datës 26.01.2024, (Raporton

Drejtoresha i DSHMS-së Rrezarta Hasani-Ibrahimi; Fjala përshëndetëse, propozim vendim Për plotësimin-ndryshimin e Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021. Sipas këtij propozim-vendimi behet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit

Komunal me Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021, për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve të DSHMS-së, për fëmijët e porsalindur nga shuma 100€, është rritur në vlerë prej 200€, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-049 për financat e pushtetit Lokal. Rritja e vlerës së subvencioneve është në funksion të mbështetjes financiare për prindit e fëmijëve të porsalindur dhe konsiston në rritjen e mirëqenies sociale të këtyre familjeve. Kjo rritje do të zbatohet për të gjitha lindjet nga data 01.01.2024.

Kryesuesja: E hapë debatin, fjalën ja kaloj:

Besart Rrecaj-PDK: Fjala përshëndetëse, një pikë jashtëzakonisht e mirë, po sa i përkëtë shumes kisha kërkuar me shty e me shqyrtua edhe një herë këtë pike nëse ka mundësi që shuma 200€ të jetë me e madhe diku 300 ose 400€, unë e përkrahi këtë pikë po që ka mundësi me rritë këtë shume?

Ali Lutfiu-PDK: Drejtoresh a banë një sqarim, ata fëmije që kanë lindur në janar e kanë aplikua për 100€, a kanë drejt me aplikua edhe për 100€, shtesë?

Mentor Mehmeti-PDK: Fjala përshëndetëse, është i mirëseardhur ky vendim për rritjen e shumes së fëmijëve të porsalindur, po e kam një pyetje të fëmijët binjak apo trinjak, a i marrin ka 200€, se cili fëmije apo vetëm 200€, po edhe unë jam qysh tha kolegu që kjo shume të rrite, në qoftë së janë mundësit.

Drejtoresha i DSHMS-së Rrezarta Hasani-Ibrahimi; Edhe ne kemi menduar që me qenë vlera me e madhe, po për shkak mundësive buxhetore është e pa mundur me qenë me shume së 200€, vitin e kaluar i kemi subvencionuar 403 lindje, diku vlera ka shkua 40,300€, vitin e kaluar i kemi pas 200mijë subvencione, në këtë vite i kemi 159mijë, ky vendim vlen për fëmijët e lindur nga 1 janari 2024, dhe fëmijët binjak apo trinjak do ti marrin së cili fëmije ka 200€, edhe fëmijët që janë subvencionua ka 100€ munden me aplikua edhe me ju shtua edhe 100€ shtesë që kanë lindur mbas 1 janarit 2024.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim miratohet Propozim-vendimi behet plotësim ndryshimi i Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr.01-400/01-0010976/21, të datës 02.03.2021, për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve të DSHMS-së, për fëmijët e porsalindur nga shuma 100€, është rritur në vlerë prej 200€.

Vazhdojmë me piken 8 të rendit të ditës:

-Pyetjet e këshilltarëve nën piken të ndryshme, fjalën ja kaloj:

Kushtrim Dragaj-PDK: Fjala përshëndetëse, Pyetje për drejtorin e Arsimit: 1. I nderuar drejtor, deri ku kanë shkuar procedurat për çerdhen e Runikut? Kur pritet të fillojë renovimi i hapësirës së destinuar për të? 2. Kur pritet të përfundojë çerdhja afër shkollës Shaban Jashari?

Për drejtorin e Urbanizimit, 3. I nderuar drejtor kur do të ndërmarim masa për analizimin e lagjes të Xhamia? Tashmë është bërë një vit që është në atë gjendje! 4. Vendosja e shtyllave të tensionit të lartë në rrugën qe e lidhë qytetin me Llaushën?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Projekti për renovimin e shkollës, në çerdhe ka ndodhur vitin e kaluar dhe këtë vite është shpallur procedura dhe në shkurtë besoj që fillojnë punimet. Çerdhja të shkolla Shaban Jashari është projekt i Bashkimit Evropian dhe në bazë të datimit që kemi pas me drejtorin e urbanizimit çerdhja do të hapet në muajin mars.

Drejtori i UUMA-së, Driton Mulaj: Sa i përkët kanalizimit besoj që ka mesi i marsit e përfundojmë po janë disa pengesa pronësoren aty, dhe për shtylla elektrike si po është pronë private problem.

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Afrim Kabashi-NSD: 1. Për Kryesuesen e Kuvendit komunal Skenderaj; Pse deri me Tani nuk janë bere pajisjet elektronike për zërimi të seancave te asamblesë, d.m.th. këtu lidhet edhe për transmetim live te seancave, dhe a keni ne plane me i bere duke pasur parasysh qe edhe kjo lidhet me transparence komunale? 2. Për Drejtorin e Arsimit; A keni planifikuar ta kryeni punën ne premtimin e dhëne ne rrethojën e oborrit te Shmu-Drenica në Polac? 3. Për Drejtorin DBF-se; A ka mundësi me mundësi buxhetore, mundësia e lejimit qe punëtove te administratës dhe kompanive për shërbime publike te paguhet shujta ne vlere 2 ose 3 euro ne mundësi buxhetore. Ketë pyetje po e beje duke u bazuar ne koston e larte e shpenzimeve familjare dhe rrogat e dobëta qe marrin punëtoret, dhe duke i pare shume punëtorë qe po e marrin bukën nga shtëpia e kame këtë breng? 4. Për Drejtorit për urbanizëm Driton Mulaj; Drejtor kure do te planifikoni ne përmisimin e çështjes se kanalizimit prapa lokaleve te bizneseve, nëse s'keni qene me pare gjendjen, është mire me shkuar me i vizitua dhe me pare me për se afërmi gjendjen e krijuar aty, e qe done një ndërhyrje të shpejte?

Kryesuesja: Afrim, seanca transmetohet live çdo herë, dhe ministria na përcjell, edhe zërimi është në kuvend, ne këtë kuvend na mungon veç kamerat, dhe jemi në planifikim, dhe procedurat kanë me kalua përmes drejtorisë së prokurimit. Fjalën ka kaloj:

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Të shkolla e Polacit jemi tu e bë një shkëmbim të pronave për ndërtimin e çerdhes afër shkollës, pastaj pason edhe ndërtimi i rrethojës me çerdhe e shkollë.


Drejtori i UUMA-së, Driton Mulaj: Jemi në dijeni për ato probleme për kanalizim për ata biznese, vitin e kaluar kemi intervenuar, ka fundi i marsit kemi me i rregullua.

Nënkryetari i Komunës, Sami Lushtaku: Kjo çështja e shujtave për zyrtaret nuk është e rregulluar me ligj, po për me qefë edhe ka dy herë në ditë ju kisha dhanë bukë, po së di a e meritojnë edhe një herë,, po besoj që DBF, e ka ndonjë përgjigje, edhe pse nuk kam pa praktik deri me tani.

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Me thanë të drejtën shujtat nuk janë të rregulluar me ligj, dhe nuk ju takojnë, jemi në një sistem tjetër që shujtat, udhëtimet nuk janë të rregulluar me ligj, as në arsim nuk janë të lejuara, kontrata kolektive që i kanë bë, i kanë bë në dëme të komunës, që Ministria e Arsimit, lidh Kontratë kolektive me sindikatën dhe ja gjunë barrën komunës, ne mundem me u dëmtua shume po ligjore nuk janë, me pas juristë të fortë këtë kontest e zgjidh.

Kryesuesja; Faleminderit, Dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq mbyllet ky takimi, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi




Kryesuesja e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 35 paragrafi 4, dhe neni 37 paragrafi 2 shkronja c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 qershor 2008, neni 3, neni 5 paragrafi 5.1.3, neni 6 ,dhe neni 7, të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, neni 30 paragrafi 4, të Statutit të Komunës së Skenderajt me Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Kuvendi i Komunës i propozoj këtë:

PROPOZIM-VENDIM

(Për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj.Fatbardha Haliti-Mustafa, me anëtares znj.Ervina Vojvoda)

- I.** Me këtë propozim-vendim propozohet të zëvendësohet anëtarja znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, nga subjekti politik “Lista e Pavarur Bekim Jashari”, me anëtares **znj. Ervina Vojvoda**, po nga i njëjti subjekt politik.
- II.** Pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shqyrtoj kërkesën e Kryesueses së Kuvendit të Komunës së Skenderajt me Nr.01-020/01-0007197/24, të datës 02.02.2024, për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj. Fatbardha Haliti-Mustafa, për arsyeje të dorëheqjes personale, si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerri vendim me Nr.01/143-2024, të datës 15.02.2024.
- III.** Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Bashkangjitur këtij propozimi-vendimi:

-Vendimin e Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Nr.01/143-2024, të datës 15.02.2024.

Iu dërgohet:

- Arkivit
- Anëtarëve të KK-së





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 15.02.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Ervina Vojvoda**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga subjekti politik "Lista e Pavarur Bekim Jashari", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Fatbardha Halili Mustafa.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Ervina Vojvoda dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 08.02.2024, Nr.09/1/113/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Fatbardha Halili Mustafa, e cila ka dhënë dorëheqje për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rënditur është znj.Ervina Vojvoda.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.


Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 15.02.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në mbështetje të nenit 11 neni 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), neni 52 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr.03/L-040, neni 5 neni 12 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.2 i Udhëzimit Administrativ me Nr.05/2020 për procedurën e Themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, neni 30 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Skenderajt me Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, i propozoj këtë:

PROPOZIM-VENDIM

(Për zëvendësimin e anëtares së Komitetit për Politik dhe Financa (KPF) znj.
Fatbardha Haliti-Mustafa)

- I. Më këtë propozim-vendim propozohet të zëvendësohet anëtarja e Komitetit për Politik dhe Financa **znj. Fatbardha Haliti-Mustafa**, nga subjekti politik “Lista e Pavarur Bekim Jashari” me anëtares nga i njëjti subjekt politik, duke e ruajtur përfaqësimin gjinor në Komitetin për Politik e Financa.
- II. Anëtarja e cekur në piken I të këtij propozim-vendimi ka ofruar dorëheqjen me shkrim nga anëtarja e kuvendit të komunës së Skenderajt, e që e njëjta ka qenë edhe anëtare e Komitetit për Politik e Financa, znj.Fatbardha Haliti-Mustafa ka dhënë dorëheqje për arsye personale dhe zëvendësimin në komiteti është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, përkatësisht neni 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, me dorëheqjen e anëtares.
- III. Ky propozim-vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Iu dërgohet:

- Arkivit
- Anëtarëve të KK-së





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

DATE/A:	13/02/2024
REFERENC-Ë	
PËR/ZA/TO	Komitetin për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës së Skenderajt, Kryesueses znj. Adelina SPAHIU
NGA OD/FROM:	Drejtoresha e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, Skenderaj znj. Blerta Dobra-Geci
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë

Të nderuar,

Kuvendi i Rep. së Kosovës në seancën e jashtëzakonshme të datës 14.12.2023 ka votuar në lexim të dytë Ligjin Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme i cili tashmë është bërë i plotfuqishëm. Ky Ligi shënon një reforme rrënjësore në Sektorin e Kadastrit dhe Gjeodezisë, unifikon legjislacionin nga fusha e Kadastrit, definon në plotëni organizimin vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, fuqizon rolin e Komisionit për Rindërtimin e informacioneve kadastrale, krijon më shumë mundësi për qasje më të lehtë të institucioneve dhe publikut në informacione Kadastrale etj.

Nga ky organizim vertikal institucional sipas Ligjit të ri do të shpëputen dy sektorët kryesor nga Drejtoria e GJKP-së sektorit të Kadastrit dhe Gjeodezisë ku si ZKK do të përfshihen në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës d.m.th do të jenë nën menaxhimin e AKK-së duke ndjekur një praktikë të bazuar në sistemin kadastral të shteteve të rajonit e më gjerë.

Ky organizim rrit besueshmërinë e qytetarëve në institucione, meqë shkurton rrugën për kërkimin e përgjegjësive nga niveli lokal në atë qendrorë, dhe do të marrin shërbime me efikasitet dhe më të shpejta.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Kadastrin e pronës së Paluajtshme do të trajtohet një nga problemet më të theksuara në të drejtën pronësore që është informaliteti i lartë. Formalizimi i të drejtave pronësore është

synim parësor në sektorin e të drejtave pronësore pasi që të drejtat pronësore të pa formalizuara mbesin jashtë qarkullimit juridik, e kjo do të realizohet përmes fuqizimit të rolit Komisionit për Rindertimin e informacioneve kadastrale i definuar me këtë Ligj.

Agjencia Kadastrale e Kosovës tashmë ka formuar grupin e saj punues ku në bashkëpunim me të gjitha Komunat janë në përfundim të Udhëzimeve Administrative për implementimin e këtij Ligji, ku në total do të jenë 14 Udhëzime Administrative të derivuara nga ky Ligj.

I gjithë stafi ekzistues i Zyres Komunale Kadastrale do të jetë nën menaxhim të Agjencisë edhe pse do të mbesin me lokacion në kuadër të Institucionit të Komunës për të ofruar shërbime sa më të lehta dhe më të mira Kadastrale qytetarëve të territorit administrativ të Komunës së Skenderajt mirëpo puna dhe detyrat e tyre do të menaxhohen nga AKK-ja.

Për tërë këtë organizim vertikal, organizim të menaxhimit të punëtorëve dhe çështje tjera me rendësi do të nënshkruhen marrëveshje të veçanta mes Komunës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Institucioni i Komunës do të ketë humbje të të hyrave nga centralizimi i këtij sektori, mirëpo qytetari është ai që do të përfitojë nga ndryshimi rrënjësor i sistemit të gjertanishëm Kadastral.

Me respekt!

Pyetjet/kërkesat e anëtareve për ekzekutivin e Komunës

1. Pyetje për Kryetarin Fadil Nura: Ne një interviste dhënë për një medium publik ne fund vitin 2023, ku keni folur rreth ndërtimit parkut biznesit keni theksuar se po pengohet nga banoret e asaj zone. Pyetja ime ndërlidhet se ne cilën fazë ka arritur projekti dhe nga cilët banorë të cilës zone po pengohet, dhe cilat do të jene masat që do të ndërmerre komuna ne raste se vazhdohet me pengesa.

2. Pyetje për Drejtorin e Urbanizmit; A pritët dhe Kure mendoni të filloni të realizoni ne ndriçimin publik ne BL-te Polacit, por edhe fshatrave tjera që gravitojnë ne komunën tone, një premtim i ekzekutivit ne fillim të mandatit.

3. Për Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Drejtor a do të vazhdoni me praktiken e njëjte sikurse viteve paraprake, ku ne thirrjet për aplikim për grande si kriter ta keni që përfituesi i cili ka përfituar ne dy vitet e fundit të mos jete përfitues, por fatkeqësisht ne praktik po ndodhe e kundërta përfitues po kemi të njëjtit vetëm po ju ndërrohen emrat, dhe për këtë besojë që keni njohuri dhe për këtë keni pasur ankesa nga fermerët.

Afrim Kabashi-NSD

Kërkese

Drejtorit të drejtorisë së inspeksionit.

Edhe pse mirëmbajtja dhe rregullimi i semaforëve është në kompetencë të ministrisë, qytetarët e lagjes 3 të cilët me se tepërmi e frekuentojnë rrugën Osman Geci ku semaforët e koordinuar gjatë, diku rreth 70 sekonda po paraqesin kolona të gjata, e kjo zakonisht ndodh në orën 16 kur dalin nxënësit nga shkolla. Me kërkesë të banorëve kërkojmë nga ju që të na ndihmoni ta zgjedhim këtë problem. Lus të hasim në mirëkuptim.

Ali Lutfiu-PDK

1. Pyetje për drejtorin e inspektoratit, Valon Haliti: Drejtor, a ke mundësi me na tregu a ke ndërmarrë ndonjë mase lidhur me objektin ne rrugën "Ahmet Delija", që si pasoje e gropimit për ndërtimin e objektit është duke u rrezikuar prona publike e private dhe objektet përreth, është dëmtuar ne mase të madhe edhe rruga ne atë pjese, dhe a ka pas leje ndërtimi!

2. Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, Alban Shala: Drejtor, a ke mundësi me u përgjigje ose me na sqarua se çka ke parapare për këtë vit për pastrimin e mbeturinave që e kane shëmtuar natyrën dhe shëndetin e njeriut, a ke bere ndonjë plan se si do i largoni këto mbeturina inerte ne komunën e Skenderaj-it.

Abdulla Gashi-IDEAL
